

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
DOKTOR

“Gjykimi i çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar“

PUNOI:

ALTINA XHOXHAI

UDHËHEQËS SHKENCOR:

PROF. DR. MARJANA SEMINI

TIRANË
JANAR 2012

©E drejta e autorit: Altina Xhoxhaj
Shtëpia Botuese

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratave”, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr.20, datë 13.11.2008.

PASQYRA E LËNDËS

<u>HYRJE</u>	5
1.1 Objekti i kërkimit shkencor.....	8
1.2 Metodologjia.....	11
1.3 Shkurtime.....	12
<u>KAPITULLI I PARË</u>	13
<u>KRIJIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR</u>	
Zhvillimi historik.....	13
Struktura e ligjit të ri për tregtarët e shoqëritë tregtare.....	17
Krijimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.....	32
Regjistrimi në QKR	45
<u>KAPITULLI I DYTË</u>	47
<u>ORGANET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR</u>	
Organet e shoqërisë.....	47
Asambleja si organ i shoqërisë.....	49
Kundërshtimi i vendimeve të asamblesë.....	57
Përgjegjësia e ortakëve.....	63
Administratorët.....	66
Emërimi dhe shkarkimi.....	70
Kompetencat e administratorëve.....	73
Përgjegjësitë e administratorëve.....	78
<u>KAPITULLI I TRETË</u>	83
<u>LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I I ORTAKUT</u>	
Largimi i ortakut.....	83
Likuidimi i kuotës.....	86
Përfundimi i ortakut.....	92

<u>KAPITULLI I KATËRT</u>	96
<u>PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR</u>	
Shkaqet e prishjes së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.....	100
Pasojat e prishjes së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.....	111
Koncepti i likuidimit.....	113
Likuidimi i thjeshtëzuar.....	122
Aneks 1.....	129
Aneks 2.....	143
<u>KONKLUZIONE</u>	152
<u>REKOMANDIME</u>	155
<u>LITERATURA</u>	158

I. HYRJE

Çfarë është shoqëria me përgjegjësi të kufizuara (ShPK)

ShPK është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Historia e ShPK në botë

Ligji për ShPK daton në shekullin e 15-të në Angli, ligj i cili kishte dhënë përgjegjësi të kufizuar për disa shoqëri tregtare në disa komunitete të Britanisë. Ndërkohë që në shekullin e 17-të, kurora mbretërore ligjëronte ShPK dhe në disa koloni britanike si p.sh. në Indi. Ligji i parë modern në botë për ShPK u miratua në shtetin e Nju Jorkut në 1811. Në Angli ligji ishte më i thjeshtë, me Aktin e 1844 për kompanitë aksionare, edhe pse investitorët në kompani të tilla mbetën me përgjegjësi të pakufizuar deri sa me Aktin e vitit 1855 përgjegjësia u kthye në të kufizuar.

Historia e ShPK në Shqipëri

Për herë të parë, shoqëria tregtare si nocion juridik është trajtuar gjerësisht në Kodit Tregtar dhe ligjën për aplikimin e tij miratuar në datën 21 nëntor të vitit 1931, quajtur ndryshe Kodi Tregtar i mbretit Zog. Kodi tregtar dhe ligji mbi aplikimin e tij u botuan në fletoren zyrtare nr. 10, datë 5 mars 1932.

Në këtë kod tregtar një vend të posaçëm zë shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur në atë kohë “shoqëria me garanci të kufizume”.

Në Kodin Tregtar dhe ligjën për aplikimin e tij trajtoheshin gjerësisht të gjitha llojet e shoqërisë, trajtoheshin organet drejtuese të tyre, asambleja, administratorët, trajtohej largimin dhe përjashtimi i ortakut për të cilin përdorej termi “shok”.

Një hapësirë dhe trajtim shumë të hollësishëm kishte prishja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare. Në kaptinën e III trajtoheshin marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve. Vëmendje i kushtohej regjistrimit të tregtisë, odës së tregtisë, veprimeve tregtare etj. Në një titull të posaçëm, pikërisht në titullin V, kaptina e 1, trajtohej përfaqësia (përfaqësuesit), të cilët vepronin brenda tagrave të dhëna dhe veprimet e tyre kishin efekt të drejtpërdrejtë mbi principalin. Megjithatë këta nuk ishin tregtarë. Dispozitat e mëvonshme trajtonin institorët, të cilët ishin persona të emëruar personalisht nga principalin për ushtrimin e tregtisë në një degë të tij ose në me shumë vende.

Gjithsej Kodi Tregtar dhe ligja për aplikimin e tij kishin 1138 nene.

Gjatë periudhës 50 vjeçare të regjimit komunist tregtia, që ushtrohej nga persona fizikë ose juridikë në mënyrë private u ndalua dhe gjithçka u përqendrua në duart e shtetit dhe të ndërmarrjeve shtetërore. Ishin këto të fundit organizmat që ushtronin tregtinë. Pas ndryshimeve demokratike në vendin tonë, u miratua ligji nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lire, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Ky ligj pati si qëllim vendosjen e një rendi të ri ekonomik në Shqipëri, në

mënyrë që të zbatohet kalimi nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë.

Në Republikën e Shqipërisë, nga ky moment, sanksionohet dhe mbrohet prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t'u punësuar, privatizimi i pronës shtetërore dhe i gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës të Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë.

Subjektet shqiptare ose të huaja ishin të lira të ushtronin veprimtaritë private të mëposhtme (por pa u kufizuar vetëm me to):

- a) si individë;
- b) me ortakëri;
- c) me kolektiva ose kooperativa;
- ç) me formim ndërmarrjesh, shoqërisht të ndryshme aksionare ose me përgjegjësi të kufizuar, anonime dhe forma të tjera të mundshme;
- d) me formim bankash, fondacionesh e institucionesh bamirësie, si dhe me forma të tjera të mundshme.

Gjithë sektorët e ekonomisë ishin të lirë të privatizoheshin dhe të ushtronin veprimtari private, përfshirë ndërmarrjet, institucionet dhe njësitë e tjera shtetërore, duke kaluar në pronë private në të gjitha fushat e veprimtarisë së prodhimit industrial, artizanal, të bujqësisë, të ndërtimit, të transportit, të shërbimeve bankare, të tregtisë së brendshme e të jashtme, të komunales, të shërbimeve jetësore, shkencore, kërkimore, kulturore e artistike, të avokatisë, të bamirësisë, të fondacioneve e të fushave të tjera të mundshme etj.

Më vonë, në datën 19.11.1992, u miratua ligji “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”. Në datën 19.11.1992 Kuvendi i Shqipërisë miratoi edhe ligjin nr. 7638 “Për shoqëritë tregtare” si dhe ligjin nr. 7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar”. Këto ligje u miratuan në një kohë që në Shqipëri nuk kishin filluar proceset integruese në Bashkimin Evropian (BE), pra nuk ishin në kushtet që jemi sot, pas miratimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Megjithatë, dhe këto ligje përafrojnë më disa direktiva të BE dhe kjo tregon se burimi i ligjeve tona pas proceseve demokratike ishte legjislacioni i BE.

Kështu ligji nr. 7632, datë 04.11.1992, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar” është pjesërisht i përafruar me Direktivën e parë 68/151/EEC dhe Direktivën e dytë 77/91/EEC, amenduar nga direktiva 92/101/EEC, lidhur me:

- Kërkesat për publikim.
- Pavlefshmërinë e shoqërive tregtare, shkaqet dhe standardet minimum.

Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me ligjin nr. 7953, datë 21.06.1995 dhe ligjin nr. 8108, datë 28.03.1996 është pjesërisht i përafruar me Direktivën e parë 68/151/EEC dhe Direktivën e dytë 77/91/EEC në këto drejtime:

- Kërkesat për publikim.
- Momentin e fitimit të personalitetit ligjor dhe marrjen përsipër të detyrimeve.
- Tejkalimin e të drejtave nga ana e shoqërive tregtare.
- Pavlefshmërinë e shoqërive tregtare, shkaqet dhe standardet minimum.
- Integritetin e kapitaleve në aksione.
- Mbrojtjen e aksionarëve në rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar.

Situata ndryshoi pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe hyrjes së saj në fuqi në datën 1 prill 2009.

Për shtetet që nuk janë anëtare të BE nuk ekzistojnë detyrime për të zbatuar aktet e nxjerra nga BE, megjithatë për ato vende të cilat janë në procesin e integritimit dhe kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, lindin një sërë detyrimesh, nga të cilët më kryesori është ai i përafritimit të legjislacioneve kombëtare.

Vendi ynë në sajë të angazhimeve të marra nga kjo marrëveshje ka filluar procesin e harmonizimit të legjislacionit si një fazë parapërgatitore në integrimin e Shqipërisë në BE. Në këtë kuadër një sërë ndryshimesh janë bërë në legjislacionin aktual, për të realizuar përafritimin e legjislacioneve.

Në këtë kuptim, ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, reflekton përmbajtjen e Direktivave të Bashkimit Evropian për Shoqëritë Tregtare.

Qëllimi i ligjvënësimit me miratimin e këtij ligji ka qenë implementimi i së drejtës evropiane. Ky qëllim, në fakt, e ka pasur burimin tek detyrimi që kishte ligjvënësi ynë në bazë të nenit 70 të Marrëveshjes së Asocimit Stabilizimit midis Shqipërisë dhe BE. Sipas kësaj dispozite vendi ynë detyrohet të bëjë një përafritim të legjislacionit tonë me *acquis communautaire* brenda 10 vjetëve.

Një numër parimesh të afirmuara më parë në Direktivat e BE për legjislacionin tregtar, kanë gjetur pasqyrim në ligjin e ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ligji duket se ka përfshirë parimet e mbrojtjes së aksionarëve në minorancë, parimet e transparencës dhe të bërjes publike të të dhënave të caktuara, pjesëmarrjen në mbledhjet e përgjithshme me anë të mjeteve elektronike, votimin me anë të prokurës, të drejtën e aksionarëve për të shtuar çështje në agjendën e mbledhjes së përgjithshme etj.

Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, nuk është realizuar një harmonizim total me të gjitha Direktivat e BE edhe për faktin se vendi ynë ende nuk është anëtar i familjes evropiane.

Këtu është për tu përmendur dhe fakti se nuk kemi një korpus koherent të së drejtës evropiane për shoqëritë tregtare. Direktivat evropiane të përmendura më sipër, përqendrohen më shumë tek shoqëritë aksionare dhe shumë pak tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Ndaj dhe ligjet për shoqëritë tregtare në vendet e BE ndryshojnë nga një vend në tjetrin, nuk kemi konventa të cilat të jenë bërë pjesë përbërëse e legjislacionit të vendeve të BE dhe, për rrjedhojë, nuk ka një korpus të përbashkët normash në lidhje me shoqëritë tregtare. Ligji ynë, në fakt, është bazuar shumë tek ligjet për shoqëritë tregtare të Gjermanisë dhe Anglisë.

Direktivat e BE për shoqëritë tregtare të cilat nuk janë përfshirë në ligjin e ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” janë si më poshtë :

1. Direktiva 2006/43/EC.¹
2. Nuk është bërë përafritim me Direktivat Evropiane që parashikojnë format e shoqërive mbi nivelin kombëtar dhe për bashkimet ndërkufitare të shoqërive.²

Me gjithë ndryshimet e shumta në legjislacion në fushën e të drejtës tregtare legjislacioni duhet të pësojë ndryshime të mëtejshme, në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet e kërkuara nga BE, për të kurorëzuar këtë proces të përpjekjeve disa vjeçare për pranimin e vendit në BE.

¹ Për auditimin e detyrueshëm dhe llogaritë vjetore”. Arsyeja e mos përfshirjes së tyre lidhet më shumë me faktin se këto janë rregullime që lidhen më shumë me auditimin se sa me shoqëritë tregtare.

² Përmendim këtu Rregulloren 21237/85 EEC “Për grupimet e interesave ekonomike evropiane” EEIG, Rregulloren 2157/2001 “Për statutin e shoqërisë tregtare evropiane” SE dhe Direktivën 2005/56/EC “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare”.

Nga sa më sipër, rezulton e qartë se dispozitat e ligjit të ri nuk përbëjnë një vazhdimësi të traditave tona të mëparshme ligjore dhe pikërisht ligjeve nr. 7638 dhe nr, 7632. Ekziston shumë pak vazhdimësi, apo aspak ndërmjet ligjit të vjetër dhe ligjit të ri për shoqëritë tregtare.³

Objekti i kërkimit shkencor

Objekti i këtij kërkimi shkencor në këtë disertacion është shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, jo vetëm në nivelin akademik por në radhë të parë dhe në nivelin praktik.

Pse shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar?

Arsyet kanë qenë profesionale por edhe personale. Ato fillojnë që nga viti 1993 ku të drejtën tregtare e mbrojta në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Studimeve të Trentos, Itali. Më vonë, fillimet e mia si gjyqtare i kam pasur pranë seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku kam punuar për më shumë se 15 vjet. Ndikim ka pasur fakti se që nga viti 2003 kam kontribuar si pedagoge e lëndës “E Drejta Tregtare” në Shkollën e Magjistraturës si dhe në disa universitete private.

Megjithatë, përveç njohjes së mirë të ShPK, mendoj se si parakusht i një punimi me vlera edhe praktike, kjo përzgjedhje ka qenë dhe rezultat i interesit tim të vazhdueshëm mbi mosmarrëveshjet që kanë lindur dhe lindin midis ortakëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, shoqërisë dhe administratorëve etj.

Ky punim është një ndërthurje e aspektit teorik, duke filluar me zhvillimin historik të ShPK e më tej me kuadrin e ri ligjor, dhe e aspektit praktik, ku përfshihet trajtimi i çështjeve të shumta të shqyrtuara dhe gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë gjatë periudhës 2008 deri në 2011.

Këto vendime janë marrë në konsideratë për nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse. Për më tepër, gjatë punimit të kësaj teme gjithmonë e më shumë krijova bindjen se ishte i nevojshëm edhe në rrafshin e një punimi akademik doktrinar, i munguar në tregun e sotëm.

Çfarë merr përsipër ky punim shkencor të studiojë?

Ky punim merr përsipër t'i përgjigjet disa pyetjeve që unë i kam çmuar të rëndësishme, të tilla si:

- A është një kontratë ShPK sipas përkufizimeve të dhëna nga ligji i ri ?
- Çfarë lloj kontrate është ShPK?
- Nëse po, a zbatohen ato dispozita që zbatohen dhe për kontratat në përgjithësi?
- Çfarë lloj marrëdhënie juridike ekziston midis administratorëve dhe shoqërisë?
- A janë parashikuar në ligj dispozita dhe mekanizmat e duhura ligjore të cilat mund të mbrojnë shoqërinë nga veprimet e paligjshme të administratorëve?

³ Autor Bachner, Th. Schuster, F E. Winner, M. *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane*, pg. 16

- A janë parashikuar në ligj dispozita që mbrojnë ekzistencën e shoqërisë si person juridik me vete nga themeluesit e saj?
- Mosmarrëveshjet midis ortakut mazhoritar dhe atij në minorancë a çojnë gjithmonë në largimin e këtij të fundit nga shoqëria?
- Si likuidohet kuota e ortakut të larguar? Si përcaktohet shuma e likuidimit?
- Përjashtimi i ortakut a është një kompetencë vetëm e asamblësë të ortakëve? Dhe a mund ta ushtrojë kjo e fundit, në çdo kohë, këtë kompetencë? Çfarë bëhet me kuotën e ortakut të përjashtuar?
- Mosmarrëveshjet midis ortakëve të shoqërisë a çojnë automatikisht në prishjen e shoqërisë dhe likuidimin e saj?
- A ka mekanizma të duhur ligjorë për mbrojtjen e ortakëve në pakicë?
- A funksionon parimi i përgjithshëm që parashikohet në Kodin Civil për kontratat kur shumica e ortakëve duan të prishin shoqërinë?
- A kemi një përafrim të legjislacionit shqiptar me *acqui communautaire*, në lidhje me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar?

Punimi ka tentuar të reflektojë mendime juridike personale, të cilat janë reagim ndaj mënyrës se si perceptohet e zbatohet ligji nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apeleve, por dhe nga ana e Gjykatës së Lartë.

Ky punim nuk lë pa prekur, gjithashtu, dhe zhvillime të së drejtës evropiane si disiplinë bashkëkohore, me debate të shumta në lidhje me shoqëritë tregtare në përgjithësi dhe ShPK në veçanti.

Qëllimi i temës.

Qëllimi i temës “Gjykimi i çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar” është të japë një përshkrim të hollësishëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, si një nga format më të përhapura të shoqërive tregtare në Shqipëri, të identifikojë shumë nga rastet tipike që janë gjykuar për këtë formë shoqërie dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga ana e gjyqtarëve, duke dhënë alternativa të tjera për zbatimin e ligjit.

Gjithashtu, ka qëllim të trajtojë ato raste kur për shkak të një boshllëku ligjor ose për shkak se nuk ka rregullim të posaçëm në ligj, nga ana praktike duket e vështirë për të gjetur zgjidhje të mosmarrëveshjeve, ndaj jam munduar të jap disa orientime se ku mund të fokusohen në të ardhmen gjyqtarët ose juristët.

Nga vendimet që kam analizuar vihet re fakti se shpesh herë gjyqtarët kanë vështirësi në identifikimin e ligjit të zbatueshëm. Duke qenë se ligji është relativisht i ri, qëllimi i këtij studimi do të jetë dhënia e një paraqitjeje të përgjithshme të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, duke filluar me trajtimin dhe analizimin e krijimit të ShPK në kapitullin e parë.

Në këtë kapitull vend do ti jepet edhe zhvillimit historik të kësaj forme shoqërie duke filluar me Kodin Tregtar të Zogut, me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të miratuar në vitin 1992 dhe do të vazhdohet me ligjin e ri, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2008.

Në kapitullin e dytë tema do të trajtojë organet e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke filluar me asamblënë e ortakëve të shoqërisë si organi kryesor i saj, mosmarrëveshjet midis ortakëve dhe praktikën gjyqësore shqiptare, në lidhje me këto mosmarrëveshje, do të vijohet me administratorët si organi ekzekutiv i shoqërisë, natyrën juridike të marrëdhënies shoqëri - administrator, mosmarrëveshjet shoqëri - administrator (ortak – administrator), si edhe praktikën gjyqësore shqiptare në lidhje me këto çështje.

Kapitulli i tretë do të trajtojë largimin dhe përjashtimin e ortakut, si institute të reja të parashikuara nga ligji i ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të cilat nuk ishin rregulluar me ligjin e vjetër. Gjithashtu, do i jepet hapësirë të gjerë praktikës gjyqësore, mënyrës se si i kanë zgjidhur gjykatat mosmarrëveshjet që lindin midis ortakëve.

Ndërsa kapitulli i katërt do të trajtojë prishjen dhe likuidimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit tonë në fuqi (një analizë juridike e këtij instituti) si dhe problemet që hasen në praktikën gjyqësore shqiptare në lidhje me prishjen dhe likuidimin.

Fundi i temës do të jenë konkluzionet përfundimtare në lidhje me problemet juridike të trajtuara në këtë temë.

Praktika gjyqësore në lidhje me mosmarrëveshjet që lindin nga organizimi dhe funksionimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuara është pothuajse e pashkelur ndaj një studim për këtë formë shoqërie, që është dhe më e përhapura, mendoj se do të jetë interesant dhe i vlefshëm për juristët dhe gjyqtarët.

II. METODOLOGJIA

Puna kërkimore për këtë disertacion ka nisur në vitin 2010 me miratimin e kërkesës sime nga departamenti i se Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Gjithsesi miratimi i kërkesës në vitin 2010, nuk më ka penguar që unë të punoj mbi këtë temë qoftë dhe me objektivin për të nxjerrë një botim të këtij lloji, pavarësisht faktit se a do arrija të mbroja një titull shkencor me të.

Puna studimore për këtë temë ka kaluar në faza të ndryshme, të raportuara edhe në departamentin e së drejtës civile, faza që shkurtimisht po i paraqes më poshtë:

Faza e parë: Seleksionimi i një literature të bollshme juridike kombëtare e ndërkombëtare mbi këtë formë shoqërie tregtare. Seleksionimi i vendimeve gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, në lidhje me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Gjithashtu, janë përzgjedhur dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë formë shoqërie.

Për këtë fazë ka ndikuar në mënyrë të jashtëzakonshme dhe mundësia që kam pasur për të gjykuar shumë çështje që lidhen me këtë formë shoqërie gjatë kohës që kam punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Po në këtë fazë përfshihet dhe “*desktop research*”, me gjetjen e një pjese të materialit botuar *online*, si metodë kërkimore që përthith informacion dhe analiza.

Faza e dytë: Analiza e materialeve të përzgjedhura, duke u trajtuar ana teorike e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar brenda kuadrit ligjor, e kombinuar kjo analizë dhe me anën praktike, me referencat në vendimet gjyqësore përkatëse.

Faza e tretë: Kjo fazë ka pasur të bëjë me përthithje të informacionit dhe literaturës së grumbulluar dhe testim në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në trajnime me juristë dhe avokatë, si dhe tryeza të rumbullakëta por dhe në botime në revista shkencore (në rubrikën “Bibliografia” kam listuar kontributet personale mbi temën).

Faza e katërt është dhe faza përfundimtare që ka të bëjë me mbrojtjen e temës së zgjedhur prej meje.

Së fundi, dua të qartësoj se, sigurisht që ky punim mund të ishte akoma më i zgjeruar me shembuj çështjesh të shqyrtuara nga gjykatat, megjithatë ai nuk merr përsipër të trajtojë vetëm anën praktike të vendimmarrjes së gjykatave.

Nëse ky punim do të shihej thjesht si prezantim i vendimmarrjes të gjykatave do ta shndërronte këtë kërkim shkencor në një analizë vjetore të gjykatave, të cilën kam dashur ta shmang si përjasje.

III. INDEKSI I SHKURTIMEVE

LTSHT	Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare
ShPK	Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar
QKR	Qendra kombëtare e regjistrimit
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KC	Kodi civil
KPC	Kodi i Procedurës Civile
KPP	Kodi i Procedurës Penale
TKE	Traktatet e Komunitetit Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim- Asocimit
OJF	Organizata Jo-fitimprurëse
GjK	Gjykata Kushtetuese
GjL	Gjykata e Lartë
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
EEC	Komuniteti ekonomik Evropian

KAPITULLI I PARË**KRIJIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

- **Zhvillimi historik.**
- **Struktura e ligjit të ri për tregtarët e shoqëritë tregtare.**
- **Krijimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.**
- **Shoqëria si marrëdhënie.**

❖ ZHVILLIMI HISTORIK

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është rregulluar për herë të parë në legjislacionin shqiptar në vitin 1931 me Kodin tregtar dhe ligjën për zbatim të tij, pra në kohën e Monarkisë së Mbretit Zog.

Kodi Tregtar u miratua në 21 nëntor të vitit 1931, është botuar në Fletoren Zyrtare në 6 mars të vitit 1932 dhe ka hyrë në fuqi 1 prill të vitit 1932, ka gjithsej 1138 nene.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar siç e kam përmendur më lart quhej “shoqëria me garanci të kufizueme.” Ky kod rregullonte në mënyrë të detajuar formimin e shoqërisë që bëhej me akt publik.⁴

Kështu ShPK ose shoqëria me garanci të kufizueme trajtohet në kaptinën III neni 143 e në vazhdim.

Ligji rregullonte në mënyrë të detajuar numrin e ortakëve të quajtur ndryshe shok.

Sipas ligjit në një shoqëri me garanci të kufizume numri i shokëve nuk mund të jetë më i madh se 25 pra ligji vendoste një nr maksimal por nuk kishte nr minimal pra mund të themelohej një shoqëri dhe vetëm me një ortak.⁵

Me miratimin e ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992 për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar, ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” si dhe ligjit nr. 7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, u krijua baza juridike dhe ligjore për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike tregtare në formën e shoqërive tregtare në përgjithësi dhe të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në veçanti.

Kështu, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar rregullohej nga një sërë nenesh të ligjit për shoqëritë tregtare, ndërsa formalitetet që zbatoheshin për krijimin e saj parashikoheshin nga disa dispozita të veçanta në pjesën e parë të Kodit Tregtar dhe në ligjin për regjistrin tregtar.

Shoqëria trajtohej si kontratë, ajo themelohej nga dy ose më shumë persona që merren vesh nëpërmjet një kontrate për të destinuar në një sipërmarrje të përbashkët

⁴ Neni 107 i Kodit tregtar të Zogut dhe ligjës për zbatimin e tij.

⁵ Neni 143 po aty.

pasuritë dhe shërbimet e tyre, me qëllimin që të ndajnë fitimin ose përfitojnë të ardhurat që mund të rrjedhin prej saj.⁶

Ortakët merrnin përsipër të paguanin pjesën që u takon në humbjet.

Ligji parashikonte se shoqëria themelohej dhe nëpërmjet aktit të vullnetit të shprehur nga një person i vetëm.

Në kreun e katërt të ligjit, neni 37 e në vazhdim, trajtohej ShPK. Neni 37 jepte përkufizimin e ShPK, udhëzimet mbi aktet dhe dokumentet. Sipas ligjit të gjithë ortakët merrnin pjesë në aktin themelues, pra ishte i detyrueshëm hartimi i një akti themelimi që në thelb përfaqësonte kontratën e shoqërisë.⁷

Gjithashtu, në dispozitat e përgjithshme të ligjit për shoqëritë tregtare parashikohej hartimi i statutit të shoqërisë. Pra, kemi dy akte të cilat në vetvete rregullojnë situata të ndryshme, në aktin e themelimit shprehet vullneti i ortakëve për të hyrë në një marrëdhënie juridike duke themeluar një organizëm të ri, shoqërinë dhe nga ana tjetër kemi statutin që rregullonte këtë organizmin dhe funksionimin e këtij organizmi.

Ligji 7632, për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar rregullonte në mënyrë të shprehur formën e kërkesave dhe akteve për regjistrim.

Ligji parashikonte se firmat që figurojnë në kërkesat për regjistrim në regjistrin tregtar dhe firmat që depozitohen në aneksin e regjistrit duhet të vërtetoheshin si autentike nga noteri ose një organ tjetër shtetëror.⁸

Gjithashtu, ligji parashikonte se pjesët e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duhet të shlyheshin tërësisht si për rastet kur përfaqësonin kapital në natyrë ashtu dhe në para.

Nga praktika personale, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sqaroj se të gjitha aktet e paraqitura nga administratori për regjistrimin e një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar kanë qenë të noteruara.

Gjithashtu, përpara gjyqtarit të regjistrin tregtar kërkuesit paraqisnin edhe aktin që provonte shlyerjen e kontributeve.

Doktrina e trajtonte shoqërinë në përgjithësi dhe shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti si një kontratë, e cila përveç konditave të nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e saj, parashikuar nga neni 663 i Kodit Civil, duhet të kishte dhe disa kushte të veçanta.

Sipas nenit 663 të Kodit Civil, që të kemi një kontratë të vlefshme duhet të ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

1. pëlqimi i palëve,
2. shkaku i ligjshëm
3. objekti i kontratës
4. forma e kërkuar nga ligj.

1. Që të ekzistojë kontrata së pari duhet të ekzistojë pëlqimi kontraktor i palëve, pa të cilin nuk mund të kemi një kontratë të vlefshme.

Kodi Civil ka pranuar dhe sanksionuar në dispozitat e tij teorinë e lirisë së vullnetit kontraktor të palëve. Në nenin 660 të tij është parashikuar se palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi. Kjo dispozitë pasqyron në thelb teorinë e Rusoit, sipas të cilës

⁶ Neni 1 i ligjit 7638 dt. 19.11.1992

⁷ Neni 39 i ligjit 7638 dt. 19.11.1992

⁸ Neni 17 i ligjit 7632 dt. 4.11.1992

njeriu është një qenie e lirë nga natyra dhe si i tillë është i lire të lidhë çdo marrëdhënie juridike.⁹

Në rastin e krijimit të ShPK pëlqimi i palëve nuk ishte gjë tjetër veçse vullneti i themeluesve për të krijuar një shoqëri, vullnet që gjente pasqyrim në formën e tij të shkruar në aktin e themelimit ose kontratën e themelimit të shoqërisë.

2. Që një kontratë të jetë e vlefshme duhet të jetë e mbështetur në një shkak të ligjshëm. Kjo nuk do të thotë se duhet të jetë patjetër një nga tipet e parashikuara në ligj, por që përmbajtja e saj duhet të jetë në pajtim me ligjin, me parimet e shtetit, me rregullat e moralit dhe interesat e palëve.¹⁰

Në rastin e ShPK shkakun është i ligjshëm, pasi sipas ligjit 7638, ShPK ishte një nga tipet e kontratave të parashikuara nga ligji.

3. Kushti i tretë që kontrata të jetë e vlefshme është që objekti që formon lëndën e kontratës, sipas nenit 678 të Kodit Civil, duhet të jetë i përcaktuar, i përcaktueshëm, i mundshëm. Objekti i kontratës, në rastin konkret, është pikërisht krijimi i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

4. Kushti i katërt është që kontrata të ketë formën e caktuar ligjore në mënyrë që të jetë e vlefshme. Kur flasim për formë të detyrueshme ligjore, kuptohet që bëhet fjala për kontratë që duhet të jetë formale, e tillë që forma e saj të kërkohet për efekt vlefshmërie ose provueshmërie. Në rastin e krijimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar forma duhet të ishte e shkruar dhe përpara noterit.

Sipas ligjit të vjetër, 7638, të gjithë këto elementë ishin të parashikuar në aktin e themelimit të shoqërisë ose në kontratën e themelimit të shoqërisë nëse do kishte më shumë se një ortak.

Ndërsa kushte specifike të kontratës së shoqërisë, sipas ligjit 7638 kanë qenë:

- a) Kontributet.
- b) Sipërmarrja e përbashkët.
- c) Qëllimi i fitimit.

Pra, në mënyrë të strukturuar kemi si më poshtë:

Kontrata në përgjithësi	Kontrata e shoqërisë në veçanti
Pëlqimi i palëve	Kontributet e përbashkëta
Shkakun i ligjshëm	Sipërmarrja e përbashkët
Objekti i kontratës	Aktivitet ekonomik
Forma e kërkuar nga ligji	Qëllimi i fitimit

⁹Semini, M E drejta e detyrimeve pg.36 Tirane 1998

¹⁰ Semini, M E drejta e detyrimeve pg. 37 Tirane 1998

Le të trajtojmë shkurtimisht kushtet që ka kontrata specifike që e dallojnë kontratën e shoqërisë nga kontratat e tjera sipas ligjit 7638.

Kontributet sipas ligjit 7638 mund të ishin në natyrë dhe para ndërsa ndaloheshin kontributet në shërbime. Ndalimi ishte në mënyrë të shprehur në nenin 40 të ligjit të sipërpërmendur. Gjithashtu ortakët detyroheshin ti shlyenin kontributet e tyre tërësisht përpara regjistrimit si person juridik të shoqërisë.

Sipërmarrja ekonomike duhet të ishte ligjshme dhe në përputhje me formën e shoqërisë që krijohet.

Qëllimi që kishin palët kur ushtronin sipërmarrjen të përbashkët ishte fitimi parashikuar në mënyrë të shprehur nga ligji i vjetër në nenin 1 të tij si dhe për ta ndarë këtë fitim sipas kontributeve në kapitalin e shoqërisë.

Pasi plotësoheshin gjithë kërkesat e mësipërm, personat e interesuar I drejtoheshin gjykatës dhe procedura vazhdonte sipas ligjit 7667 për regjistrin tregtar dhe formalitet që duheshin respektuar. Sipas këtij ligji regjistri tregtar mbahej në gjykatën e rrethit të Tiranës për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.¹¹

Kështu gjyqtari vendoste për kërkesat e regjistrimit brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në gjykatë. Ai vendoste për gjithë publikimet e nevojshme. Sipas ligjit të sipërpërmendur gjyqtari mund të konsultohet dhe të merrte vërejtjet përkatëse nga dhoma e tregtisë në rastin regjistrimeve të emrave të rinj tregtare.

Me miratimin e ligjit 9901/2008 ne kemi një kuadër ligjor të ndryshëm nga ligji i mëparshëm. Kjo ka ndodhur për shumë faktorë. Siç e përmenda dhe më lartë, qëllimi i ligjvënësit me miratimin e këtij ligji ka qenë implementimi i së drejtës evropiane në dispozitat e ligjit të ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ky qëllim, në fakt, e ka pasur burimin tek detyrimi që kishte ligjvënësi ynë në bazë të nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit midis Shqipërisë dhe BE. Sipas kësaj dispozite, vendi ynë detyrohet të bëjë një përafrim të legjislacionit tonë me *acquis communautaire* brenda 10 vjetëve. Është për tu përmendur dhe fakti se nuk kemi një korpus koherent të së drejtës evropiane për shoqëritë tregtare. Direktivat evropiane të përmendura më lart, përqendrohen me shumë tek shoqëritë aksionare dhe shumë pak tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Ndaj dhe ligjet për shoqëritë tregtare në vendet e BE ndryshojnë nga një vend në tjetrin, nuk kemi konventa të cilat të jenë bërë pjesë përbërëse e legjislacionit të vendeve të BE dhe, për rrjedhojë, nuk ka një korpus të përbashkët normash në lidhje me shoqëritë tregtare. Ligji ynë në fakt është bazuar shumë tek ligjet për shoqëritë tregtare të Gjermanisë dhe Anglisë.

Nga sa më sipër, rezulton e qartë se dispozitat e ligjit të ri nuk përbëjnë një vazhdimësi të traditave tona të mëparshme ligjore dhe pikërisht të ligjeve nr. 7638 dhe nr. 7632. Ekziston shumë pak vazhdimësi, apo aspak ndërmjet ligjit të vjetër dhe ligjit të ri për shoqëritë tregtare.¹²

Përpara se të trajtoj natyrën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si një nga llojet e shoqërive tregtare të rregulluara nga ligji 9901/2008, e çmoj me vend të ndalem në paraqitjen e strukturës së ligjit të sipërcituar.

¹¹ Neni 1 i ligjit 7667dt 28.1.1993

¹² Bacher, Th, Schuster. E –P, Winner . M, Ligji i ri i shqiptar për shoqëritë tregtare, pg. 16

❖ STRUKTURA E LIGJIT

Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare rregullon katër lloje subjektsh tregtare të quajtura me termin e përgjithshëm shoqëri tregtare.

Subjektet e rregulluara nga ligji janë si më poshtë:

- shoqëritë kolektive;
- shoqëritë komandite;
- shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
- shoqëritë aksionare.

Në një kuptim shumë të gjerë, këto katër lloje shoqërish u përgjigjen llojeve të mëposhtme të subjekteve tregtare që veprojnë në dy prej juridiksioneve evropiane me të cilat unë jam konsultuar edhe për hartimin e kësaj teme:

Shqipëri	Mbretëria e Bashkuar	Itali
shoqëritë kolektive	partnership	società in nome collettivo
shoqëritë komandite	limited partnership	società in accomandita semplice
shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara	private company limited by shares	società a responsabilità limitata
shoqëritë aksionare	public company limited by shares	società a responsabilità limitata

Ligji ynë për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ashtu si dhe legjislacioni italian i jep personalitet juridik të katër llojeve të shoqërive tregtare.

Ndryshe është qëndrimi që ka legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar, ku si persona juridikë njihen vetëm shoqëritë e kapitalit dhe pikërisht *private company limited by share*, që i korrespondon ShPK dhe *public company limited by shares* që i korrespondon shoqërive aksionare tek ne.

Struktura e ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” është si më poshtë:

• Pjesa e parë	Dispozita të përgjithshme
• Pjesa e dytë	Shoqëri kolektive
• Pjesa e tretë	Shoqëria komandite
• Pjesa e katërt	ShPK

• Pjesa e pestë	ShA
• Pjesa e gjashtë	Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese
• Pjesa e shtatë	Grupimi i shoqërive
• Pjesa e tetë	Shoqëria shtetërore
• Pjesa e nëntë	Riorganizimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe i shoqërive anonime
• Pjesa e dhjetë	Dispozita të fundit dhe kalimtare

Në vijim do të bëj një paraqitje të detajuar të përmbajtjes së të gjithë ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Paraqitja e kësaj përmbajtjeje është konceptuar të bëhet në përputhje me ndarjen që i kam bërë në tabelën e mësipërme. Në çdo pjesë do të paraqitet shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur përmbajtja e secilës dispozite të tij, të trajtuara sipas vendosjes së tyre rendore në ligj, por pa vendosur numrin e nenit përkatës, duke u ndalur në atë çka ajo trajton dhe, në rastet që e kam vlerësuar më të përshtatshme, duke paraqitur një përshkrim më të zgjatur të parashikimit përkatës ligjor.

Trajtimi është i ndarë sipas pjesëve të ligjit, do të thotë në dhjetë pjesë, ku secila prej tyre do të paraqitet e ndarë sipas titujve dhe secili titull edhe sipas krerëve të tij.

Pjesa e parë – Dispozitat e përgjithshme

Kjo pjesë e parë trajton dispozitat e përgjithshme, të përfshira në titullin I, duke nisur me objektin e këtij ligji që është rregullimi i statusit të tregtarit, themelimi dhe administrimi i shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare, ku këto të fundit janë shoqëritë kolektive, komandime, ato me përgjegjësi të kufizuar dhe ato aksionare; detyrimin për regjistrimin e tregtarëve dhe shoqërive tregtare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe detyrimi për mbajtjen e librave kontabël e hartimin dhe publikimin e të dhënave financiare të veprimtarisë; përkufizimi i tregtarit i cili është personi fizik që ushtron veprimtari ekonomike të pavarur që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm; përkufizimi i shoqërive tregtare të cilat themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkëta, duke dhënë kontribute në shoqëri sipas statutit dhe që fitojnë personalitet juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në QKR; emrat e regjistruar dhe emërtimet tregtare nën të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtari dhe shoqëritë tregtare të cilat duhet të plotësojnë kërkesat sipas kësaj dispozite; transferimi i emrave dhe i përgjegjësive, në rastet e transferimit të veprimtarisë së tregtarit ose shoqërisë tregtare.

Më tej, në titullin II të kësaj pjese, trajtohet themelimi i shoqërisë tregtare, duke nisur më specifikisht me statutin i shoqërisë; objekti i ligjshëm i veprimtarisë së saj që mund të jetë çdo veprimtari e cila nuk ndalohet me ligj; çfarë kuptohet me zyrë qendrore të shoqërisë tregtare e përcaktuar si vendi ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare; degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërisë që mund të hapen nga personat përgjegjës të shoqërisë, ku degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare kurse zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare dhe të dyja dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë; përgjegjësia e personave që veprojnë në emër të shoqërisë përpara se të fitojë personalitetin juridik (përgjegjësia e themeluesve) të cilët përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të shoqërisë por që me fitimin e personalitetit juridik të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë; të dhënat që duhet të përmbajnë të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence i nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit të saj, të cilat u drejtohen palëve të treta nëpërmjet korrespondencës me letër apo mjete elektronike, të dhëna për vërtetësinë e të cilave përgjigjet shoqëria.

Në titullin III të kësaj pjesë paraqiten rregullat për përfaqësimin e shoqërive tregtare duke nisur me përfaqësuesit ligjorë të saj dhe kompetencat e tyre, të cilët duhet të zbatojnë të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet e shoqërisë; ndalimet për mbajtjen e funksionit të përfaqësuesit ligjor, si dhe rastet e konfliktit të interesit dhe personat e lidhur me ta.

Në titullin IV trajtohet parimi i detyrimit të besnikërisë, të cilit duhet ti përmbahen ortakët, aksionarët, administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo atij mbikëqyrës, gjatë ushtrimit të të drejtave, dhe që kërkon që ata të veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe ortakëve apo aksionarëve të tjerë; e drejta e informimit të ortakëve apo aksionarëve nga personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë, për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, ne rast se kërkohet, e drejta që tu vihen në dispozicion llogaritë vjetore, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtimet përkatëse; përgjegjësia në rastet e abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë sipas të cilës ortakët, aksionarët, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose veprimet e parashikuara nga kjo dispozitë; përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë më të gjithë pasurinë e tyre; ndalimi i konkurrencës që kërkon që ortakët e shoqërisë kolektive, ortakët e pakufizuar të shoqërisë komandime, ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si edhe administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të një shoqërie aksionare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik; sekretit tregtar që paraqitet si një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria e mbron në mënyrë të përshtatshme, i cili nëse do të përhapej do të shkaktonte një dëm të konsiderueshëm për interesat tregtare të shoqërisë, si dhe rastet kur informacioni nuk përbën sekret tregtar, duke parashikuar si të tillë atë informacion që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare.

Kjo pjesë e parë e ligjit mbyllet me titullin V, në të cilin trajtohen çështjet që lidhen me pjesëmarrjen e punëmarrësve në shoqërinë tregtare; rregullat lidhur me krijimin dhe organizimin e këshillit të punëmarrësve, të krijuar në shoqëritë tregtare me më shumë se 50 punëmarrës mandat maksimal prej 5 vitesh, kurse funksionet e një shoqërie tregtare që ka më shumë se 20 punëmarrës, por më pak se 50, kryhen nga një përfaqësues për çdo 10 punëmarrës; të drejtat dhe detyrimet e këtij këshilli i cili monitoron zbatimin e ligjeve, kontratave kolektive dhe dispozitave të statutit, përfaqëson interesat e punëmarrësve të shoqërisë, merr pjesë në vendimmarrjen për shfrytëzimin e fondeve të posaçme dhe të aktiveve të tjera të shoqërisë si dhe në shpërndarjen e pjesës së fitimeve që asambleja e përgjithshme vendos tua shpërndajë punëmarrësve; si dhe pjesëmarrja e punëmarrësve në administrimin e shoqërive aksionare nëpërmjet personave të emëruar nga përfaqësuesi ligjore i shoqërisë tregtare dhe këshilli i punëmarrësve.

Pjesa e dytë – Shoqëritë kolektive

Në këtë pjesë ligji fokusohet në trajtimin e shoqërisë kolektive, duke nisur me përkufizimin e saj si një shoqëri që regjistrohet si e tillë dhe kryen veprimtari tregtare nën një emër të përbashkët dhe përgjegjësia e ortakëve përpara kreditorëve është e pakufizuar si dhe detyrimi për regjistrimin e saj në përputhje me ligjin për QKR-në (titulli I).

Në titullin II ligji trajtohen marrëdhëniet midis ortakëve, të cilat rregullohen nga statuti i shoqërisë në përputhje me parimin e lirisë kontraktore; kontributet e ortakëve të cilat janë të barabarta dhe mund të jenë në para ose në natyrë, ata i vlerësojnë kontributet në natyrë duke e shprehur vlerën e tyre në para me anë të një marrëveshje të ndërsjellë me njëri-tjetrin dhe nëse kjo marrëveshje nuk arrihet secili mund ti drejtohet gjykatës për caktimin e një eksperti vlerësuese; përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë përmbushjes së detyrimeve nga ortakët, të cilët përgjigjen për të gjitha dëmet e shkaktuar me dashje ose me pakujdesi të rëndë; rimbursimi i shpenzimeve të nevojshme të bëra gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë që i kërkohet shoqërisë nga të gjithë ortakët; rastet e vonesave në pagimin e kontributeve nga ortakët, për kalimin e parave të arkëtuara apo që janë marrë nga shoqëria pa autorizim, për të cilat ata detyrohen të paguajnë dhe interes mbi vlerat që detyrohen; rritja apo zvogëlimi i vlerës së kontributit të ortakut; disponimi i pjesëve nga ana e secilit ortak, i cili nuk mund të heqë dorë, të transferojë apo të vendosë barrë mbi të drejtat që rrjedhin nga pjesa e tij në shoqëri pa miratimin e ortakëve të tjerë, kurse në shoqëritë kolektive këto të drejta mund të transferohen pa asnjë kufizim në ortakët e tjerë; administrimi i veprimtarisë tregtare të shoqërisë nga ana e ortakëve, ku të gjithë kanë të drejtë të veprojnë si administratorë; në rastin kur e drejta për administrim u është dhënë më shumë ortakëve ose disave prej tyre secili prej administratorëve ka të drejtë të veprojë në mënyrë të pavarur kurse kur statuti parashikon që administratorët mund të veprojnë vetëm në mënyrë të përbashkët për çdo veprim kërkohet miratimi i të gjithë administratorëve; objekti i administrimit i cili përfshin kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë tregtare, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin e të gjithë ortakëve; kalimi i të drejtave të administratorit nga një ortak një pale të tretë me miratimin e të gjithë ortakëve të tjerë;

njoftimi i dorëheqjes për detyrat e tij nga ana e administratorit, për shkaqe të arsyeshme, me njoftim paraprak dhe në një kohë të përshtatshme dhe heqja e të drejtave për administrim ortakut me vendim të gjykatës përkatëse, me kërkesë të ortakëve të tjerë, për shkaqe të arsyeshme përfshirë shkeljen e rëndë të detyrave të administratorit ose paaftësinë për ti përmbushur ato në mënyrë të rregullt; marrja e vendimeve nga ortakët për rastet kur vendimet duhet të merren nga ortakë nominalisht të përcaktuar dhe kërkohet miratimi i të gjithë ortakëve; humbja dhe fitimi i shoqërisë që rezultojnë në fund të çdo viti financiar nga përgatitja e pasqyrave financiare, dhe ku secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në mbulimin e humbjeve.

Në titullin III të kësaj pjesë gjejmë të trajtuar marrëdhëniet ndërmjet ortakëve dhe të tretëve, duke nisur nga dispozitat për përfaqësimin e shoqërisë kolektive, ku parashikohet se secili ortak ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe çdo përjashtim i ortakëve nga e drejta e përfaqësimit duhet të njoftohen për regjistrim pranë QKR-së; njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për përfaqësim që kërkon që përfaqësuesi i shoqërisë që jep dorëheqjen nga detyrat të njoftojë paraprakisht shoqërinë në një kohë të përshtatshme dhe duke pasur parasysh mundësinë e përfaqësuesve të tjerë për të vijuar veprimet e ndërmarra nga ai pas dorëheqjes; përgjegjësia personale e ortakëve sipas të cilës ortakët përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë me të gjitha pasuritë e tyre dhe kreditori personal i ortakut mund të ekzekutojë kreditë që ka ndaj tij duke ekzekutuar kreditë që ortakët ka ndaj shoqërisë si dhe pjesën që ai zotëron në shoqëri; prapësimet më anë të të cilave mund të mbrohet ortakët nëse një kreditor ngre padi ndaj një ortakut për detyrimet e shoqërisë; përgjegjësia e ortakut të ri, pra personit që fiton cilësinë e ortakut në shoqëri kolektive ekzistuese, i cili merr përsipër detyrimet e shoqërisë përfshirë edhe detyrimet që ekzistonin përpara se ta fitonte këtë cilësi.

Në titullin IV trajtohen rregullat lidhur me prishjen e shoqërisë kolektive dhe largimin e ortakëve, ku parashikohen shkaqet për prishjen e shoqërisë; rastet që pasjellin largimin e ortakut por jo prishjen e shoqërisë; njoftimi i ortakut që vendos të largohet nga shoqëria, njoftimi i cili, në rastet kur shoqëria është themeluar për një afat të pacaktuar, duhet tu bëhet i ditur me shkrim ortakëve të tjerë 6 muaj përpara largimit; njoftimi nga kreditori personal i ortakut, të cilit në rast se nuk ka arritur të ekzekutojë kreditë e tij ndaj i lind e drejta të kërkojë shoqërisë likuidimin e pjesës që zotëron ortakët në shoqëri; prishja e shoqërisë me vendim gjykate, për shkaqe të arsyeshme, në bazë të padisë të ngritur nga një ortak, nëse një nga ortakët me dashje ose si pasojë e pakujdesisë së rëndë nuk ka kryer detyrat e caktuara në statut apo kryerja e tyre është bërë e pamundur; përjashtimi i ortakut përgjegjës për moskryerje të detyrave, i cili vendoset nga gjykata mbi bazën e padisë të ngritur nga një ortak, por pa vendosur prishjen e shoqërisë; ndarja e pjesës të ortakut që ikën, në mënyrë proporcionale ndërmjet ortakëve të mbetur; procedura në rastet kur mbetet vetëm një ortak, i cili duhet që të marrë masat për ta përshtatur shoqërinë me kërkesat e këtij ligji ose të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë duke u regjistruar si tregtar; vazhdimi i shoqërisë nga trashëgimtarët e ortakut të vdekur nëse kjo lejohet në statut dhe pranohet nga këta të fundit; detyrimi i ortakëve të njoftojnë në QKR për aktet, faktet e prishjes dhe largimit të ortakëve.

Në titullin V të kësaj pjese paraqiten rregullat lidhur me likuidimin e shoqërisë kolektive, procedura të cilat hapen si pasojë e prishjes së shoqërisë kolektive në

gjendjen e aftësisë paguese; paditë ndaj një ortaku për detyrimet e shoqërisë ngrihen brenda 3 vjetëve pas prishjes së saj, parashkrim që nis në datën kur është regjistruar prishja e shoqërisë; ortaku i larguar nga shoqëria përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që kanë lindur përpara largimit të tij, nëse kanë lindur përpara 3 viteve nga data e këtij largimi, dhe parashkrimi në këtë rast nis në datën e regjistrimit të ortakut.

Pjesa e tretë – Shoqëria Komandite

Në këtë pjesë të tretë gjejmë të trajtuar shoqërinë kolektive, e cila përkufizohet si shoqëria në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij (ortaku i kufizuar) ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar (ortak i pakufizuar), ku ky i fundit ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive; regjistrimi i kësaj shoqërie bëhet sipas rregullave të ligjit për QKR; marrëdhëniet ndërmjet ortakëve; administrimi i veprimtarisë tregtare të shoqërisë komandime mund të kryhet nga një ose më shumë ortakë të pakufizuar pasi ortakët e kufizuar nuk kryejnë veprime administrimi; përballimi i humbjeve të shoqërisë nga ortaku i kufizuar bëhet deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera; ndalimi i përfaqësimit ligjor sipas të cilit ortaku i kufizuar nuk mund të veprojë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite; përgjegjësia e ortakut të kufizuar, i cili përgjigjet personalisht ndaj kreditorëve të shoqërisë kolektive deri në vlerën e kontributeve të pashlyera, dhe ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë në rast se ka shlyer të gjitha kontributet e tij; ndryshimet në kontributin e ortakëve, rritje apo zvogëlim i kontributit; duhet ti njoftohen për regjistrim QKR; përgjegjësia nga perceptimi i cilësive ligjore; përgjegjësia përpara regjistrimit sipas të cilës kur themeluesit e shoqërisë komandite marrin përsipër detyrime për veprimtarinë tregtare të shoqërisë, përpara regjistrimit të saj në QKR, ortaku i kufizuar që pranon të marrë përsipër këto detyrime përgjigjet si të ishte ortak i pakufizuar; përgjegjësia e një ortaku të ri të kufizuar për detyrimet që kanë lindur përpara fitimit të kësaj cilësie, i cili e fiton këtë cilësi në një shoqëri komandite ekzistuese; largimi i një ose më shumë ortakëve të kufizuar, i cili nuk pas sjell prishjen e shoqërisë komandime, përveç kur të gjithë ortakët e pakufizuar largohen nga shoqëria, kurse në rast se largohen të gjithë ortakët e kufizuar veprimtaria tregtare e shoqërisë mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie kolektive apo të ndryshojë edhe në statusin e tregtarit.

Pjesa e katërt – Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara

Në pjesën e katërt ligji trajton shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara, duke nisur në titullin I, me përkufizimi e kësaj lloji shoqëri si një shoqëri tregtare e themeluar nga persona fizikë ose juridikë të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e saj deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara, kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital, i cili mund të jetë në para ose në

natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme ose të drejta); shoqëria me përgjegjësi të kufizuar regjistrohet sipas dispozitave të ligjit për QKR; kapitali minimal i shoqërisë me përgjegjës të kufizuar nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë; nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt dhe nga çasti i regjistrimit të ndryshimit ajo vijon aktivitetin si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm, fakt që duhet të regjistrohet në QKR.

Në titullin II, trajtohen kuotat dhe kalimi i kuotave dhe më konkretisht zotërimi i kuotave që mund të bëhet nga një ose më shumë persona, në rast se një kuotë e kapitalit zotërohet nga më shumë se një person këta persona trajtohen si një ortak i vetëm dhe të drejtat e tyre ushtrohen nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët dhe përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kësaj kuote; mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave të kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre; pasojat e kalimit të kuotave, ku personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen solidarisht ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i asaj kuote nga çasti i kalimit deri në çastin e regjistrimit të këtij kalimi, kalimi që duhet të regjistrohet në QKR; pjesëtimi i kuotave dhe transferimin e tyre mund të bëhet në rast se kjo nuk është e ndaluar nga statuti i shoqërisë.

Në titullin III trajtohen marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve lidhur me shpërndarjen e fitimeve të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë, fitim i cili shpërndahet midis ortakëve në raport me kuotat e zotëruara nga ata; kufizimet e shpërndarjeve të lidhura me pagimin e dividendit dhe certifikata e aftësisë paguese që lëshohet nga administratorët dhe që konfirmon se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e këtij neni; përgjegjësia personale e administratorëve për shpërndarjet e ndaluara në rastin kur nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, të cilët përgjigjen për kthimin e dividendëve të shpërndarë, kurse ortakët që kanë marrë nga shoqëria dividendë përgjigjen personalisht për kthimin e dividendëve që u janë shpërndarë pa u lëshuar certifikata e aftësisë paguese; rikthimi i shpërndarjeve të ndaluara; anulimi i kuotave nga shoqëria, anulim që mund të bëhet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës, e drejtë kjo e shoqërisë që mund të parashikohet nga statuti.

Titulli IV i kësaj pjese merret me trajtimin e organeve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, duke nisur në Kreun I me Asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet e saj, çështjet për të cilat ajo është përgjegjëse për marrjen e vendimeve, vendime të cilat duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve me pasojë pavlefshmërinë absolute të tyre; mbledhja e asamblesë së përgjithshme e cila thirret në rastet e parashikuar në këtë ligj, në ligje të tjera, dispozitat e statutit dhe sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, mbledhje që thirret nga administratorët apo ortakët; mënyra e thirrjes së saj që kërkon një njoftim me shkresë ose elektronik, dhe elementët që duhet të përmbajë ky njoftim; kërkesa për thirrjen e asamblesë së përgjithshme apo përfshirja e çështjeve të posaçme në rendin e ditës nga ortakët e pakicës, që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, forma e kërkesës dhe elementët që duhet të përmbajë ajo; përfaqësimi në asamble i ortakut mund të bëhet nga një ortak tjetër ose një person i tretë në bazë të një autorizimi, por administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme; kuorumi për marrjen e vendimeve që kërkojnë shumicë të

zakonshme apo të kualifikuar; marrja e vendimeve që me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet e përcaktuara specifikisht në këtë nen, kurse për çështjet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës; e drejta e votës sipas të cilës çdo kuotë jep të drejtën e një vote; përjashtimi nga e drejta e votës për ortakun në rastet kur asambleja e përgjithshme merr vendime për disa çështje të caktuara; procesverbalet e mbledhjes, të cilat duhet të plotësojnë elementet e përcaktuara në këtë nen dhe ku duhet të regjistrohen të gjitha vendimet e asamblesë; e drejta e asamblesë së përgjithshme për të vendosur nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, hetim i cili kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës, e drejtë që duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit di dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare; e drejta e asamblesë së përgjithshme ti kërkojë gjykatës shfuqizimin e vendimeve të parregullta të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të ligjit ose të statutit, dhe dëmshpërblimi; të drejtat e lidhur me kuotën në bazë të të cilave ortaku që pengohet në ushtrimin e tyre ka të drejtë ti kërkojë gjykatë ndalimin e cenimit; ndalimi i parashikimeve që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve në dispozitat e statutit çka i bën ato të pavlefshme.

Kreu II i këtij titulli parashikon rregullat që lidhen me administratorët, duke nisur me dispozitat lidhur me emërimin e një ose më shumë personave fizikë si administratorë nga asambleja e përgjithshme, afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, shkarkimi i tyre nga asambleja e përgjithshme në çdo kohë me shumicë të zakonshme, të drejtat dhe detyrimet e administratorëve; përfaqësimi dhe kufizimi i tagrave të përfaqësimit të cilat i kundër drejtohen palëve të treta, tagra që njoftohen për regjistrim në QKR; shpërblimi për administratorët i cili duhet të jetë i përshtatshëm, në përputhje me detyrat e tyre dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, ai përcaktohet me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme dhe shpërblimit bazë mund ti bëhen shtesa në përqindje në fitim ose të ngjashme; detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia a administratorëve, të cilët gjatë kryerjes së detyrave të tyre përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare dhe nëse ata veprojnë në kundërshtim me detyrat apo me standardet profesionale janë të detyruar ti dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kjo shkelje.

Në titullin V, Kreu I, përfshihen dispozitat që lidhen me prishjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar; detyrimi që administratorët të regjistrojnë prishjen e shoqërisë në QKR dhe nëse prishja bëhet me vendim gjykate detyrimi për ti njoftuar vendimin gjyqësor QKR për regjistrim.

Kreu II i këtij titulli përfshin largimin dhe përjashtimin e ortakëve; largimin e ortakut për shkaqe të arsyeshme, si të tilla konsiderohen nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar në ushtrimin e të drejtave të tij, nëse i janë ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo shkaqe të tjera që bëjnë te pamundur vazhdimin e ortakërisë, largim që duhet ti njoftohet shoqërisë me shkrim bashkë me shkaqet dhe që sjell thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për të vendosur nëse atij do ti likuidohet kuota; rasti i përjashtimit të ortakut me vendim të gjykatës nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme, e kërkuar nga asambleja e zakonshme në bazë të një vendimi të zakonshëm të saj, dhe shoqëria ka të drejtë ti kërkojë ortakut

shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet e tij kurse ortakut ka të drejtë ti kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit nëse kërkesa për përjashtimin e tij nuk është e bazuar; si pasojë e largimit dhe përjashtimit të ortakut të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo cilësi në shoqëri shuhet në datën e largimit ose të vendimit gjyqësor për largimin ose përjashtimin; prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit.

Pjesa e pestë – Shoqëritë aksionare

Në pjesën e pestë ligji trajton shoqëritë aksionare, duke nisur, si edhe në pjesët e trajtuar më sipër, me përkufizimin e kësaj shoqërie si një shoqëri tregtare kapitali i të cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit, ku themeluesit janë persona fizikë ose juridike që nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara; detyrimi për regjistrimin e kësaj shoqërie në QKR; kapitali minimal i cili në shoqëritë aksionare me ofertë private nuk mund të jetë më i vogël se 2.000.000 lekë, kurse në shoqëritë aksionare me ofertë publike nuk mund të jetë më i vogël se 10.000.000 lekë; llojet e kontributeve të aksionarëve të cilat mund të jenë në para apo në natyrë, por jo në punë ose në shërbime; vlera nominale dhe emetimi i aksioneve ku çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale dhe aksionet nuk të emetohen dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen para regjistrimit të shoqërisë në QKR; vlera e aksioneve të emetuara ku vlera e përgjithshme nominale e tyre nuk mund të jetë më e vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë; kostot e themelimit të cilat mund të kërkojnë nga themeluesit që të rimbursohen nga shoqëria dhe u paguhen themeluesve nga fitimet që realizon shoqëria; kontributet në natyrë të aksionarëve të cilat duhet të vlerësohen para regjistrimit të shoqërisë në QKR nga ekspertë të caktuar nga gjykata; shlyerja dhe kalimi i kontributeve përpara regjistrimit; dispozitat e posaçme për shoqëritë me aksionar të vetëm si dhe procedura e themelimit.

Në titullin II përfshihen rregullat lidhur me aksionet; llojet dhe kategoritë e aksioneve të cilat mund të jenë të zakonshme ose me përparësi dhe të drejtat që secili prej këtyre lloj aksionesh u japin zotëruesve të tyre; mënyra e fitimit dhe kalimit të aksioneve; akti i emetimit të aksioneve i cili hartohet në çastin e emetimit fillestar të tyre; regjistrimi i aksioneve në regjistrin e posaçëm të shoqërisë aksionare dhe të dhënat që duhet të përmbajë çdo regjistrim, me pasojën që personat që regjistrohen prezumohen si aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota në marrëdhëniet me shoqërinë dhe me të tretët; kushtëzimi për kalimin e aksioneve që mund të kërkojë pëlqimin e organeve drejtuese të shoqërisë dhe/ose të drejtën e parablerjes nga aksionarët e tjerë; zotërimi i përbashkët i aksioneve që mund të bëhet nga një ose më shumë persona të cilët përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet që rrjedhin nga ky zotërim; të drejtat e votës ku çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni dhe ku aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote.

Titulli III trajton marrëdhëniet ligjore ndërmjet shoqërisë dhe aksionarëve, duke nisur më detyrimin e aksionarëve për të paguar kontributet që kërkon që të shlyejnë vlerën nominale të aksionit apo çmimin më të lartë të emetimit në llogarinë e

shoqërisë dhe kalojnë kontributin në natyrë; pasojat e vonesës së shlyerjes së kontributit në para nga ana e aksionarit; ndalimi i faljes së detyrimit mbi kontributet që ndalon shoqërinë të falë detyrimin për të shlyer kontributet në para apo kalimin e kontributeve në natyrë të nënshkruara nga aksionarët; ndalimi i kthimit të kontributeve aksionarëve; rezerva ligjore dhe rezervat e tjera; deklarimi i dividendit, i cili është pjesa që i takon secili aksionar nga vlera e fitimeve vjetore që vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme, dhe që shpërndahet mes aksionarëve në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë; detyrimi i aksionarëve për rikthimin e pagesave të paligjshme shoqërisë, që janë të gjitha shumat e përfituara nga ajo në kundërshtim me dispozitat e ligjit, padi që parashkruhet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së pagesës së parregullt; shpërblimi i aksionarit për transaksionet ndërmjet tij dhe shoqërisë i cili nuk mund të jetë më i lartë se vlera normale që ka tregu në atë çast për veprime ekonomike të ngjashme; mos shlyerja e kredisë në rastet kur aksionari i jep hua shoqërisë duke zbatuar kushte më pak të favorshme nga kushtet normale që ofron tregu, i cili nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin e huasë nëse ky veprim do të kishte si pasojë reduktimin e kapitaleve të shoqërisë nën vlerën e kapitalit minimal; përgjegjësia për kreditë e shlyera; ndalimi i nënshkrimit të blerjes së aksioneve sipas të cilit shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta dhe blerja e aksioneve të veta nga shoqëria lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

Titulli IV përfshin rregullat që lidhen me organet e shoqërisë aksionare, duke nisur me emërtimin e këtyre organeve dhe publikimin e tyre.

Kreu I i këtij titulli trajton asamblenë e përgjithshme, nëpërmjet të cilës ushtrohen të drejtat e aksionarëve për çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet e saj, çështjet për të cilat asambleja e përgjithshme merri vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatës, dhe në rastin kur shoqëria zotërohet nga një aksionar të drejtat dhe detyrimet e saj ushtrohen nga ky aksionar i vetëm; rastet në të cilat mbledhet asambleja e përgjithshme dhe thirrja e saj nga administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët; mënyra e thirrjes së asamblesë së përgjithshme nëpërmjet njoftimit me shkresë ose nëse parashikohet nga statuti edhe nëpërmjet njoftimit elektronik, të gjithë elementët që duhet të përmbajë njoftimi dhe informacioni që duhet ti vihet në dispozicion aksionarëve përpara mbledhjes; rendi i ditës i cili duhet të njoftohet dhe duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje; mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës i kërkuar nga aksionarët e pakicës, ku përfshihen aksionarët të cilët zotërojnë aksione që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël të parashikuar në statut, dhe që në kërkesën me shkrim drejtuar administratorëve ku të kërkojnë edhe përfshirjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës; përfaqësimi në asamble i aksionarëve nga një aksionar tjetër apo një person i tretë në bazë të një autorizimi; pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme sipas rregullave të përcaktuara në statut apo nga asambleja e përgjithshme; pjesëmarrja me mjete komunikimi elektronike, nëse kjo është e parashikuar në statut, për aksionarët që nuk janë të pranishëm dhe çfarë përfshijnë mjetet elektronike por me kusht që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e këtyre ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në masën që përdorimi të jetë proporcional me arritjen e qëllimit për të cilin përdoret; procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme në të cilat duhet të regjistrohen të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme dhe për ruajtjen e të cilave janë përgjegjës administratorët, si dhe elementët që duhet të përmbajë

procesverbali i mbledhjeve; kuorumi për marrjen e vendimeve nga asambleja e përgjithshme i ndarë sipas çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme dhe atyre që kanë nevojë për një shumicë të kualifikuar; marrja e vendimeve që kërkon një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e votave të aksionarëve që marrin pjesë në votim për çështjet e parashikuara specifikisht nga kjo dispozitë, kurse për çështjet e tjera marrja e vendimeve kërkon shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë në mbledhje; mënyra e votimit e cila, nëse nuk parashikohet ndryshe, është e hapur, kurse për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve kjo mënyrë votimi është e fshehtë nëse kjo kërkohet nga aksionarët që zotërojnë një numër aksionesh që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë; e drejta e votës sipas të cilës çdo aksion mbart të drejtën e një vote; përjashtimet nga ushtrimi i të drejtës së votës; aksionet më përparësi, pa të drejtë vote, të cilat gëzojnë të gjitha të drejtat e tjera që rrjedhin prej zotërimit të tyre, por nëse përparësia anulohet ato aksione rifitojnë të drejtën e votës; hetimet e posaçme të cilat mund të fillojnë me vendim të asamblesë së përgjithshme për parregullsitë në veprimet e themelimit të shoqërisë dhe të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, hetim i cili kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës; shfuqizimi i vendimeve të parregullta të administratorëve, këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, mund ti kërkohet gjykatës kompetente nga asambleja e përgjithshme atëherë kur këto vendime konsiderohen si shkelje të rënda të ligjit ose statutit, gjykim në të cilin asambleja e përgjithshme merr pjesë me anë të administratorëve, me anë të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës apo edhe nëpërmjet në përfaqësuesi të posaçëm të caktuar prej saj; të drejtat e lidhura me aksionin, në bazë të të cilës aksionari që pengohet të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i aksionit mund ti kërkojë gjykatës urdhërimin e ndalimit të cenimit apo edhe dëmshpërblim dhe kjo padi duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga pengimi i ushtrimit të kësaj të drejte; ndalimi i kufizimeve që bën të pavlefshme ato dispozitat të statutit që kufizojë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e aksionarëve ose kreditorëve.

Në kreun II të këtij titulli përfshihen ato dispozitat që rregullojnë këshillin administrativ, ose e quajtur sistemi me një nivel, duke nisur me të drejtat dhe detyrimet e këtij këshilli; numrin, emërimin dhe përbërjen e këshillit të administrimit i cili përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh por jo më shumë se 21 anëtarë, të cilët janë individë shumica të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, dhe që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme; zgjedhshmëria e kufizuar e anëtarëve të këshillit të administrimit të cilët mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë si dhe individë jashtë shoqërisë dhe rastet e pazgjidhshmërisë në këtë detyrë; shkarkimi i anëtarit të këshillit të administrimit nga asambleja e përgjithshme, në çdo kohë, vendim që merret me shumicë të thjeshtë të votave; administratorët të cilët emërohen nga këshilli i administrimit për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet si dhe të drejtat dhe detyrimet e këtyre administratorëve; kufizimet në tagrat e përfaqësimit të administratorëve; shpërblimi për anëtarët e këshillit të administrimit, që lidhet me pagën bazë të tyre dhe shpërblimet shtesë; rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme të këshillit të administrimit; marrja e vendimeve nga këshilli i administrimit të cilat vlerësohen të vlefshme nëse në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve të tij dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm; detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia për administratorët dhe anëtarët e këshillimit të administrimit; përgjegjësia solidare e këshillit të administrimit dhe e administratorëve për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare dhe informacione kryesore të veprimtarisë së shoqërisë; kërkesa për mbikëqyrje të veçantë për çështje të posaçme.

Kreu III përfshin dispozitat që lidhen me administratorët dhe këshillin mbikëqyrës apo sistemi me dy nivele, sistem në të cilin administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli drejtues në cilësinë e organit mbikëqyrës këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin; përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët.

Në titullin V të kësaj pjese gjejmë dispozitat lidhur me kapitalin duke nisur me kreun I që trajton dispozitat e përgjithshme dhe më konkretisht kushtet për të gjitha format e zmadhimit të kapitalit; regjistrimin dhe publikimin e rritjes së kapitalit në QKR; ndalimin e emetimit të aksioneve sipas të cilit përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet në QKR aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat e lidhur me to nuk mund të transferohen; fillimi i pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve si dhe zmadhimi i kapitalit dhe shoqëria me aksionar të vetëm.

Kreu II lidhet me zmadhimin e kapitalit me emetim të aksioneve të reja dhe më konkretisht me kushtet për rritjen e kapitalit të regjistruar të shoqërisë; e drejta e parablerjes e aksionarëve për aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar.

Në kreun III trajtohen kushtet për zmadhimin e kufizuar të kapitalit me emetim të aksioneve të reja.

Në kreun IV trajtohen kushtet për zmadhimin e autorizuar të kapitalit, e drejtë kjo që mund tu jepet administratorëve nga statuti ose një vendim i asamblesë së përgjithshme, vlerë që nuk mund të jetë më e madhe se gjysma e kapitalit të e madhe se gjysma e kapitalit të regjistruar të shoqërisë në datën në të cilën merret vendimi për zmadhimin e autorizuar.

Në kreun V trajtohet zmadhimi i kapitalit me aktive të shoqërisë, duke nisur me kushtet për zmadhimin e kapitalit të regjistruar; regjistrimin dhe publikimin e zmadhimit të kapitalit me aktivet e shoqërisë si edhe shpërndarja proporcionale e aksioneve të emetuara rishtazi, kurse në kreun VI trajtohen obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim.

Titulli VI i kësaj pjese përfshin dispozitat lidhur me zvogëlimin e kapitalit, duke nisur me kreun I që trajton zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit, kushtet për zvogëlimin e tij me vendim të asamblesë së përgjithshme; regjistrimi dhe publikimi i vendimit për zvogëlimin e kapitalit në QKR; mbrojtja e të drejtave të kreditorëve, pretendimet e të cilëve janë ngritur përpara datës së publikimit të vendimit për zvogëlimin e kapitalit.

Kreu II trajton kushtet për zvogëlimin e thjeshtëzuar të kapitalit, kurse kreu III trajton kushtet për zvogëlimin e kapitalit me anulim aksionesh.

Titulli VII përfshin dispozitat që lidhen me prishjen e shoqërisë, duke nisur me shkaqet e prishjes së shoqërisë aksionare; detyrimin për regjistrimin e prishjes së shoqërisë; likuidimin në gjendjen e aftësisë paguese.

Pjesa e gjashtë – Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Në titullin I të kësaj pjesë përfshihen dispozitat që rregullojnë likuidimin e zakonshëm në gjendjen e aftësisë paguese, duke nisur me dispozitat e përgjithshme

sipas të cilave prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi; emërimi i likuiduesve i cili në shoqëritë kolektive dhe komandime kryhet nga të gjithë ortakët apo nga një likuidues i emëruar në mënyrë unanime prej tyre, kurse në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruara nga asambleja e përgjithshme; emërimi i likuiduesve nga gjykata, i cili bëhet në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim të gjykatës; shkarkimi i likuiduesve, procedurë që bëhet në të njëjtat kushte të parashikuara nga ligji për emërimin e tyre; të dhënat e likuiduesve dhe tagrat e tyre i njoftohen QKR nga administratorët e shoqërisë, si dhe çdo ndryshim në identitetin dhe tagrat e tyre; ftesa për kreditorët e cila bëhet nga likuiduesit që kreditorët të depozitojnë pretendimet e tyre për prishjen e shoqërisë, njoftim i cili botohet dy herë; administrimi nga likuiduesit, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij, kurse nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues ata ushtrojnë bashkërisht të drejtat dhe detyrimet, përveçse kur akti i emërimit parashikon ndryshe; të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit, ku detyra të tij parashikohet mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit si dhe veprime të tjera tregtare; bilancet e gjendjes së shoqërisë të cilat përgatiten nga likuiduesi në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave; mbrojtja e kreditorëve që nuk lejoj shpërndarjen nga likuiduesit të aktiveve të mbetura përpara përfundimit të afatit 3 mujor nga publikimi i thirrjes së dytë drejtuar kreditorëve për të depozituar pretendimet e tyre; raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi i likuiduesve të cilët lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport pas miratimit të raportit për procedurën e likuidimit nga ortakët e shoqërisë kolektive ose komandime apo nga asambleja e përgjithshme, kurse nëse raporti nuk miratohet ata mund të drejtohen gjykatës me kërkesë për shkarkimin e tyre nga detyra; shpërndarja e aktiveve të mbetura të cilat u shpërndahen ortakëve apo aksionarëve, sipas të drejtave që kanë në ndarjen e fitimeve, pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve; përfundimi i likuidimit për të cilën njoftohet nga likuiduesi QKR; përgjegjësia e likuiduesit, veprimtaria e të cilit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga QKR, dhe ata përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve.

Në titullin II trajtohet procedura e likuidimit të thjeshtëzuar, kushtet dhe procedura për realizimin e procedurës të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët, dhe asaj të thjeshtëzuar për të cilën administratorët duhet të njoftojnë në QKR; si dhe fshirja pas likuidimit të shkurtuar.

Pjesa e shtatë – Grupimi i shoqërive

Në këtë pjesë të shtatë të ligjit trajtohet grupimi i shoqërive tregtare, duke nisur me detyrimin për informim sa herë që një person fiton apo kalon aksione të një shoqërie aksionare çka sjell ndryshime në numrin e përgjithshëm të votave të zotëruara në asambleenë e përgjithshme; mëma dhe shoqëritë e kontrolluara, dhe vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar kur një shoqëri

tregtare sillet e vepron rregullisht sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër, kontroll i cili quhet grup kontrollues; pasojat e ekzistencës së grupit të kontrollues të cilat janë se në rast të ekzistencës së marrëdhënies mëmë-shoqëri e kontrolluar shoqëri e kontrolluar shoqëria mëmë detyrohet të mbulojë humbjet vjetore të shoqërisë së kontrolluar dhe ortakët apo aksionarët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë ti kërkojnë në çdo rast mëmës t'u blejë kuotat, aksionet apo obligacionet e zotëruara prej tyre në shoqëri kurse kreditorët e shoqërisë së kontrolluar mund ti kërkojnë në çdo rast mëmën tu ofrojë garanci për kreditë e tyre; detyrimi i besnikërisë në grupin influencues; përgjegjësia për dëmin në rast se përfaqësuesi i shoqërisë mëmë ka shkelur detyrimin e besnikërisë, të cilat bien mbi shoqërinë në emër të të cilës ka vepruar përfaqësuesi; padia për shpërblimin e dëmit duke parashikuar rastet e ngritjes së kësaj padie e cila mund të ngrihet brenda tre vjetëve nga data kur është vënë re dëmi; e drejta e shitjes të aksioneve ose kuotave të mbetura të shoqërisë së kontrolluar në rastet kur mëma zotëron 90% ose më shumë të pjesëve, aksioneve apo kuotave të shoqërisë së kontrolluar.

Pjesa e tetë – Shoqëria shtetërore

Kjo pjesë e tetë e ligjit përfshin rregullat që lidhen me shoqërinë shtetërore, e përkufizuar si një shoqëri tregtare që zhvillon veprimtari tregtare me interes të përgjithshëm ekonomik, por që aksionet e të cilës zotërohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pushteti qendror, ai vendor apo nga një shoqëri ku këto pushtete veprojnë si mëmë dhe ku themelimi, organizimi dhe funksionimi i kësaj lloj shoqërie tregtare i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji të trajtuara në pjesët e tjera të tij.

Pjesa e nëntë – Riorganizimi i shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe i shoqërive anonime

Dispozitat e përfshira në këtë pjesë të ligjit janë të zbatueshme vetëm për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. Ajo nis me dispozitat e përgjithshme që përcaktojnë se riorganizimi i një shoqërie mund të bëhet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ndarjes në dy apo më shumë shoqëri apo shndërrimit të formës së saj ligjore.

Titulli I i kësaj pjese trajton rastin e riorganizimit të shoqërisë nëpërmjet bashkimit, mënyrat e bashkimit të dy ose më shumë shoqërive. Kështu kreu I i këtij titulli trajton rastin e bashkimit me përthithje nëpërmjet një projekt marrëveshje të përfaqësuesve ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim dhe elementët që përmban marrëveshja; raporti i ekspertëve të caktuar nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, ekspertë që janë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshëm, me qëllim të vlerësimit të kushteve të marrëveshjes, të cilët mund të caktohen nga gjykata nëse kjo kërkohet, të cilët hartojnë një raport me shkrim dhe çështjet mbi të cilat ata duhet të shprehen; miratimi i marrëveshjes së bashkimit, e cila prodhon efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive që marrin pjesë në bashkim; zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë përthithëse që kryhet në kuadër të bashkimit nuk u nënshtrohet disa parashikimeve të

përcaktuara; regjistrimi, publikimi dhe pasojat e tij, pas njoftimit për bashkimin në QKR nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim së bashku me aktet që duhet ta shoqërojnë këtë njoftim; mbrojtja e kreditorëve, të cilëve duhet tu jepet garanci të mjaftueshme për kreditë e tyre në rast se brenda 6 muajve nga publikimi i projekt marrëveshjes paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre; mbrojtja e zotëruesve të të drejtave të veçanta të cilëve duhet tu garantohen të njëjtat të drejta që gëzojnë në shoqërinë e përthithur; mbrojtja e të drejtave të ortakëve dhe aksionarëve, në rastin kur ata nuk kanë dhënë pëlqimin për bashkimin dhe kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksione apo kuotave që zotërojnë, apo me çmimin e përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pavarur; përgjegjësia e organeve të administrimit, të organeve mbikëqyrëse të cilët përgjigjen solidarisht, bashkë me shoqërinë përthithëse për dëmet që ortakët, aksionarët dhe kreditorët e shoqërive që marrin pjesë në bashkim kanë pësuar nga ky veprim, si edhe ekspertët e angazhuar në vlerësimin e bashkimit; bashkimi me përthithje në raste të veçanta, që mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë mëmë në rastet kur kjo e fundit kontrollon të paktën 90% të kapitalit të regjistruar të një shoqërie aksionare. Në kreun II të këtij titulli përcaktohen dispozitat e zbatueshme në rastin e bashkimit me themelim të një shoqërie të re.

Titulli II trajton riorganizimin e shoqërisë nëpërmjet ndarjes së saj, duke përfshirë përkufizimin dhe dispozitat e zbatueshme në rastet e ndarjes të shoqërisë, e cila mund të kryhet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuara të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluar rishtazi.

Titulli II trajton riorganizimin e shoqërisë nëpërmjet shndërrimit të saj, duke nisur me dispozitat e përgjithshme lidhur me ndryshimin e formës ligjore të një shoqërie nëpërmjet shndërrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në aksionare dhe anasjelltas, shndërrimit të shoqërisë aksionare me ofertë private në shoqëri aksionare me ofertë publike e anasjelltas; procedurën për shndërrimin që kërkon nga administratorët e shoqërisë që shndërrohet të hartojnë një raport të hollësishëm ku shpjegohen baza ligjore dhe ekonomike për realizimin e shndërrimit, vendim që merret nga asambleja e përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave dhe njoftohet për regjistrim në QKR, regjistrim që sjell efektet e përcaktuara në ligj.

Pjesa e dhjetë – Dispozitat e fundit dhe kalimtare

Në pjesën e fundit të tij ligji paraqet dispozitat e fundit dhe ato kalimtare që lidhen vijimin e funksionimit dhe detyrimin për përshtatje për shoqëritë tregtare ekzistuese në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, duke parashikuar se ato do të vazhdojnë funksionimin sipas mënyrës dhe kushteve që kanë qenë të vlefshme në çastin e regjistrimit të tyre dhe kanë detyrimin për te përshtatur organizimin dhe funksionimin sipas dispozitave të tij brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi, përndryshe do të vlerësohen të prishur dhe çregjistrohen nga QKR pas përfundimit të procedurës së likuidimit; si dhe shfuqizimet e disa akteve ligjore.

❖ KRIJIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Shoqëria si kontratë.

Përpara se të trajtoj natyrën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si një nga llojet e shoqërive tregtare të rregulluara nga ligji 9901/2008, e çmoj me vend të ndalem në disa aspekte të shoqërisë si koncept, duke e trajtuar nga dy pikë vështrime: në fazën e saj të krijimit dhe të ekzistencës së saj si marrëdhënie.

Duke ju referuar momentit të krijimit të shoqërisë, duket sikur ligjvënësi ka hequr dorë nga përkufizimi i shoqërisë si një kontratë,¹³ duke u ndalur vetëm në përcaktimin e shoqërisë me origjinë kontraktuale.

Kjo duket nga nenin 3 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ku parashikohet se: *Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak të vetëm)*

Në dispozitat e ligjit të ri për tregtarët e shoqëritë tregtare nuk flitet më për kontratë por për “persona fizikë ose juridikë që bien dakord”. Por përdorimi i shprehjes “që bien dakord” korrespondon me pëlqimin e palëve.

Në Kodin Tregtar të Zogut shoqëria trajtohej si kontratë e krijuar me akt publik.

Gjithashtu, dhe në ligjin e vjetër për shoqëritë tregtare, shoqëria trajtohej si kontratë. Në nenin 1 të ligjit nr. 7638, datë 19.1.1992 parashikohet se shoqëria themelohej nga dy ose më shumë persona, të cilët merren vesh nëpërmjet një **kontrate për të destinuar** në një sipërmarrje të përbashkët pasuritë ose shërbimet e tyre me qëllim të ndajnë fitimin.

Në ligjin e ri nuk flitet më për sipërmarrje të përbashkët me qëllim ndarjen e fitimit por për “arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët”.

Qëndrimi i ri që mban ligjvënësi në lidhje me mos përdorimin e termit kontratë mund të jetë i kuptueshëm, pasi faza e lindjes, krijimit të një shoqërie tregtare jo domosdoshmërisht mund të jetë kontratë në kuptimin klasik. Them këtë, pasi si shoqëritë aksionare ashtu dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara mund të krijohen dhe nga vullneti i një subjekti të vetëm, mund të krijohen dhe për efekte të ligjit etj.

Pra, mund të ndodhë që akti i krijimit të shoqërive tregtare të këtë më shumë natyrë negociuese ose më saktësisht kontraktuale, se sa një kontratë në kuptimin pastër të këtij koncepti.

Megjithatë, në përputhje me legjislacionin tonë por dhe atë të vendeve të Bashkimit Evropian është pranuar gjerësisht fakti se një shoqëri tregtare është një marrëdhënie kontraktuale dhe, si e tillë, ka praninë e gjithë atyre elementeve që parashikohen në legjislacionin civil për kontratat.

Doktrina ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar për sa i takon faktit se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar hyn në kategorinë e kontratave.¹⁴

¹³ Përkufizim historik i shoqërisë si kontratë në legjislacionin tonë i ka fillesat që në kodin Tregtar të Mbretit Zog

¹⁴ Doktrina këtu është unanime. Shiko Giuseppe Giacomo Auletta Il contratto di societa commerciale, Milano 1937; Ferrara F. Jr , Corsi F, Gli imprenditori e le societa pg. 237, G. Ferri La societa e come contratto, in diritto e pratica commercilae Milano 1942 pag. 259(208) etj.

Në doktrinën tonë nuk është trajtuar fakti se çfarë lloji kontrate është shoqëria në përgjithësi, rrjedhimisht dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar në veçanti. Duke u bazuar në literaturën e zgjedhur për këtë qëllim do mundohem ti kthej përgjigje kësaj pyetje.

Shoqëria në përgjithësi hyn në kategorinë e kontratave të bashkëpunimit, karakteristikat e së cilës mund ti analizojmë duke bërë një krahasim me kontratat e shkëmbimit.¹⁵

Në kontratën e shkëmbimit qëllimi i palëve kontraktuese është i ndryshëm, p.sh. shitësi do çmimin, blerësi do sendin dhe secili nga kontraktuesit arrin qëllimin e tij nëpërmjet përmbushjes që bën pala tjetër në mënyrë të rregullt të detyrimeve që burojnë nga kontrata. Në kontratat e bashkëpunimit qëllimi i palëve është i njëjtë për të gjithë.

Në shoqëritë tregtare në përgjithësi, dhe në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti, qëllimi i të gjithë ortakëve është fitimi. Ky fitim realizohet nëpërmjet ushtrimit të një aktiviteti ekonomik (tregtar) të përbashkët ku të gjithë bashkëpunojnë, pra kemi qëllim të njëjtë të përbashkët. Kontributet e secilit ortak në shoqëri nuk kanë si qëllim përmbushjen e interesave të ortakëve të tjerë, por ato përdoren për zhvillimin e një aktiviteti tregtar të përbashkët.

Në fakt kontributet e ortakëve për themelimin e një shoqërie janë thjesht mjete ose instrumente për të marrë fitimin që do ndahet midis ortakëve. Ato mund të jenë të ndryshme në natyrë dhe në vlerë.

Kontributet e secilit ortak nuk qëndrojnë në një marrëdhënie të kushtëzuar, d.m.th. që nëse nuk i shlyen njëri nuk i shlyen dhe tjetri, por qëndrojnë në një situatë paralelizmi për të prokuruar një fitim dhe thelbi i kontratës është përqendruar në zhvillimin e aktivitetit ekonomik të përbashkët që përbën pjesën me të rëndësishme të saj.¹⁶

Nga ky qëndrim i doktrinës vjen dhe pasoja që mos shlyerja e kontributit nga njëri nga ortakët, për shkak vullnetit të tij ose për shkaqe të tjera, nuk shkakton mos përmbushje të thelbit të kontratës së shoqërisë, e cila mund të vazhdojë të funksionojë normalisht. Pra, mund të themi se kemi një pavarësi relative të kontratës nga palët kontraktuese (çka do trajtohet dhe më vonë tek përjashtimi i ortakut që ka lidhje pikërisht me natyrën e veçantë të kontratës së shoqërisë në përgjithësi dhe shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti).

Kjo kategori kontraktuale nëse mund ta quajmë kështu, ka gjetur pasqyrim dhe në ligjin e ri "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" kur flitet për palë që **bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët duke dhënë kontribute në shoqëri**. Pra, për të arritur objektivat ekonomike të përbashkët ortakët bashkëpunojnë duke dhënë kontribute. Në këtë kuptim kontributet e palëve janë për arritjen e një qëllimi të përbashkët, zhvillimi i aktivitetit ekonomik me qëllim fitimin, çka është specifika e kësaj kontrate.

Në lidhje me sa më sipër ka disa rregulla të caktuara, të cilat doktrina i ka trajtuar gjerësisht dhe që e dallojnë kontratën e shoqërisë nga kontratat e tjera.¹⁷

Të tilla janë si më poshtë:

- a) Nuliteti që mund të prekë detyrimin e njëres prej palëve nuk sjell nulitetin e gjithë kontratës.

¹⁵ Ascarelli T Consorzi volontari tra imprenditori Milano Guiffre editori 1937 pg 37

¹⁶ Ascarelli T shiko Il contratto plurilaterale in Saggi Giuridici pg. 259 Milano 1949.

¹⁷ Shko F.Ferrara Jr, F.Corsi Gli imprenditori e le società . pg 253

- b) Në mënyrë analoge, nëse kontributi i njërit prej palëve është i anulueshëm për ves në vullnet ose për pamundësi përmbushjeje, atëherë kemi vetëm anulim të kontributit dhe jo të gjithë kontratës.
- c) Mos përmbushja që mund të bëjë njëra nga palët nuk i jep të drejtë palëve të tjera të mos derdhen kontributet e tyre, por vetëm ju lind e drejta të përjashtojnë ortakun që nuk përmbush detyrimin.
- d) Pamundësia e përmbushjes së detyrimeve të njëres prej palëve nuk sjell prishjen e raportit në lidhje me gjithë palët e tjera, por vetëm pala që nuk ka realizuar përmbushje nuk bën më pjesë e kontratës.¹⁸

Megjithatë rregullat e mësipërme zbatohen nëse plotësohen dy kushte.

Së pari që kontrata të ketë më shumë se dy palë, nuk mund të zbatohen nëse kemi një kontratë vetëm me një kontraktues.

Së dyti që mos përmbushja e detyrimit nga pala kontraktore sipas rrethanave nuk mund të konsiderohet e rëndësishme. P.sh. nëse nuk mund të realizohet objekti i kontratës pasi është bërë i pamundur realizimi për shkak faktor etj, atëherë kontrata nuk mund të ekzistojë.

Këto janë rregulla të përgjithshme, të cilat janë të zbatueshme dhe për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si një lloj kontrate bashkëpunimi.

Tipi kryesor i kontratave të bashkëpunimit përbëhet nga kontrata e shoqërisë, megjithatë shumë kontrata të tjera hyjnë në këtë kategori si shoqëria e thjeshtë rregulluar nga Kodi Civil, organizatat e ndryshme jo fitimprurëse, shoqatat, fondacionet, qendrat, kontratat agrare, kontrata për bashkëpunim afatgjatë prodhues etj.¹⁹

Shoqëria tregtare në përgjithësi dhe ajo me përgjegjësi të kufizuara në veçanti dallohet nga kontratat e tjera të bashkëpunimit sepse ka tre elementë që mund ti konsiderojmë tipike për shoqërinë, si më poshtë:

- a) Kontributi i ortakëve.
- b) Objektivat ekonomike të përbashkët.
- c) Qëllimi për të arritur një fitim për ortakët.

A. Kontributi i ortakëve.

Qëndrimi i doktrinës është se nuk mund të ketë shoqëri pa kontribute ashtu si nuk mund të jesh ortak i një shoqërie nëse nuk ke dhënë kontribute.²⁰

Nëse disa persona vendosin të zhvillojnë një aktivitet të përbashkët dhe të formojnë kapitalin e shoqërisë me fitimet e para shoqëria lind menjëherë, duke pasur si kapital të ardhurat nga veprimtaria e saj.

Në këndvështrimin e përgjithshëm kontributet janë detyrime që u vihen ortakëve nga kontrata e shoqërisë.²¹

¹⁸ Shiko nenet 1420, 1446, 1459,1466 Kodi Civil Italian

¹⁹ Kontrata për kooperim afatgjatë profesor Dr Mehdi J Hetemi Detyrimet dhe kontrata pg374.

²⁰ Bolaffi R, La societa semplice pag. 173 Giuffre editore 1975

Megjithëse në thelb detyrimi për kontribute nuk ndryshon nga detyrimet e tjera kontraktuale ka disa karakteristika që e dallojnë nga kontratat e tjera, të cilat janë:

- Kontributet siç u përmend dhe më lart janë të lidhura ngushtësisht me zhvillimin e aktivitetit ekonomik të përbashkët.
- Interesi i ortakut në shoqëri nuk varet nga shlyerja e kontributit prej ortakëve tjerë por nga zhvillimi i aktivitetit ekonomik me qëllim fitimin.

Megjithëse detyrimi për të sjellë kontribute është i përgjithshëm, pra për të gjithë ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nëse është parashikuar në kontratë ose statut, kjo nuk do të thotë se kontributet janë të njëjta në lloj dhe të barabarta në vlerë.

Ligji ka lejuar që ortakët, me marrëveshje midis tyre, të vendosin se si do të jenë kontributet e tyre. Ligji ka parashikuar se ortakët mund të kontribuojnë në para ose në natyrë, gjithashtu ortakët janë të lirë të përcaktojnë vlerën e kontributeve të tyre.

B. Objektivat ekonomikë të përbashkët.

Kur ligji flet për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, bazuar në interpretimin literal, por dhe duke ju referuar doktrinës dhe burimeve të ligjit në të drejtën evropiane, kjo nuk është gjë tjetër veçse bashkëpunim për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik dhe tregtar të përbashkët.

Ky është një element tjetër që dallon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nga fondacionet, shoqatat etj., për faktin se palët (ortakët) në ShPK duhet të zhvillojnë një aktivitet ekonomik të përbashkët me kontributet e dhëna, ndërsa shoqatat, fondacionet kanë qëllimin të zhvillojnë aktivitete kulturore, sportive, bamirësie etj. pa pasur objektiva ekonomikë.²²

Aktiviteti, siç e thotë dhe vetë dispozita, duhet të ketë përmbajtje ekonomike.

Aktiviteti duhet të jetë i ligjshëm, i mundur dhe i përcaktuar (megjithatë përcaktimi i objektit të veprimtarisë është lënë në vullnet të ortakëve, mos përcaktimi i objektit nuk e pengon shoqërinë të regjistrohet si person juridikë, ligji e lejon që të fitojë personalitet).

Kështu, nëse një shoqëri ushtron aktivitet kriminal ajo është nul, pavarësisht se ligji jonë nuk e ka rregulluar këtë pjesë por zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Gjithashtu nul është dhe shoqëria që zhvillon aktivitet imoral.

C. Qëllimi për të arritur një fitim për ortakët.

Në këtë formulim të ri që ka dhënë ligji shqiptar për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në nenin 68 të tij, por edhe ai i dhënë në nenin 3 për shoqërinë tregtare në përgjithësi, nuk përcaktohet se një nga qëllimet kryesore të themelimit të një shoqërie tregtare, pra të rënies dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, është qëllimi i fitimit dhe ndarja e tij midis ortakëve. Megjithatë, çdo aktivitet ekonomik ka si qëllim fitimin. Përgjithësisht bëjnë organizatat jo fitimprurëse të cilat mund të

²¹ Berberi, B, Shoqëritë tregtare pg. 32.

²² Sipas një pike vështrimi tjetër dallimi midis shoqërisë dhe fondacioneve, shoqatave etj nuk ka lidhje me qëllimin por me strukturën e marrëdhënies. Shoqëria themelohet nga subjekte fikse dhe bazohet në besimi reciprok ndërsa entet që përmendëm më sipër përbehen nga pjesëtarë të ndryshëm, trup . shiko Ferrara Senior Le persone giuridiche Torino 1956 pga. 74-5

ushtrojnë aktivitet ekonomik por fitimi i realizuar nga aktiviteti i tyre përdoret për interesat e organizatës.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit të ri paraqitet si një formë e pavarur shoqërie. ShPK dhe shoqëritë aksionare janë shoqëri kapitali, megjithatë ShPK është subjekt me natyrë hibride, ajo paraqet elemente të shoqërive të kapitalit dhe karakteristika të shoqërive të personit.²³

Natyrë e shoqërive të personit ndeshet në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në lidhjen e kontratës midis ortakëve të cilët në të shumtën e rasteve bazohen në njohjet personale. Ndërsa natyrë e shoqërisë së kapitalit ndeshet në mënyrë e organizimit dhe funksionimit të saj, që ngjan më shumë me shoqëritë aksionare.

Në literaturën evropiane, por dhe në literaturën akademike shqiptare kjo formë shoqërie është konsideruar dhe “*si shoqëri e personave me përgjegjësi të kufizuar*”.

Kjo ka ndodhur dhe ndodh për shkak të kompetencave që ligji ju ka njohur themeluesve të shoqërisë, d.m.th. ortakëve, për të përcaktuar rregullat e funksionimit në momentin kur miratojnë statutin dhe më vonë kur e ndryshojnë atë. Sjella e ortakëve mund të bëjë që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga organizimi dhe funksionimi i saj të afrohet më shumë me një shoqëri aksionare ose me një shoqëri komandite apo kolektive.²⁴

Referimi tek shoqëritë e personave nuk bëhet aspak për të kundërvënë shoqëritë me përgjegjësi të pakufizuar me ato me përgjegjësi të kufizuar, e aq më pak duhet bërë për të klasifikuar shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar në grupin e shoqërive me pavarësi pasurore pra të përjashtuara nga personaliteti juridik.²⁵

Shprehja “shoqëria e personave me përgjegjësi të kufizuar” justifikohet edhe me faktin se pavarësia e palëve në marrëdhënie gëzon liri të tillë që të organizojë shoqërinë edhe sikur praktikisht të ishte një shoqëri personash ose shoqëri kapitali.²⁶ Për shembull, në bazë të statutit të gjithë ortakët mund të jenë administratorë dhe mund të ushtrojnë veçanërisht ose bashkërisht pushtetin e tyre të administrimit, vendimet e ortakëve mund të merren për çështje të caktuara me shumicë më të lartë se ajo që përcakton ligji; transferimi i kuotave pjesëmarrëse mund të varet nga pëlqimi i të gjithë ortakëve, përjashto të drejtën e heqjes dorë etj. Pra, ky emërtim ka lidhje pikërisht me rolin thelbësor që kanë ortakët për të organizuar shoqërinë sipas dëshirës së tyre.

Nga pikëpamja e ligjit shqiptar nuk ka dyshim që shoqëria me përgjegjësi të kufizuar bën pjesë në grupin e shoqërive me kapital, gjë që del qartë në kreun VI të ligjit “Për shoqëritë tregtare” të titulluar “likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese”. Kjo pjesë e dispozitave të ligjit është një disiplinë që ndan shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nga ato kolektive dhe komandite.²⁷

Për më tepër, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar konsiderohet si një shoqëri me kapitale, pasi ortakët (të paktën normalisht) nuk bien në sy për aftësitë e tyre shlyerëse, kjo për arsye të përgjegjësisë së kufizuar për detyrimet e shoqërisë. D.m.th. ortakë përgjigjet për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në të, ndërsa është vetë shoqëria që përgjigjet me gjithë pasurinë e saj për detyrimet që ka ndaj të tretëve. Pra, teknikisht shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri me kapitale ose shoqëri kapitali.

²³ Argita Malltezi E drejta shqiptare e shoqërive tregtare fq 45

²⁴ Argita Malltezi Cikel leksionesh për të drejtën tregtare pg. 32

²⁵ Argita Malltezi E drejta shqiptare e shoqërive tregtare pg. 44

²⁶ Argita Malltezi E drejta shqiptare e shoqërive tregtare pg. 54

²⁷ Neni 191 /2i ligji 9901/2008

Nga pikëpamja e se drejtës tregtare formimi i ShPK kalon nëpër dy faza.

Së pari, ShPK formohet nga ortakët themelues të cilët lidhin marrëveshje me njëri tjetrin, marrëveshje që përfshin dhe rregullimet e mëtejshme të jetës së kësaj krijese që po themelohet, rregullime që si rregull parashikohen në statut.

Së dyti, themeluesit ose përfaqësuesit e tyre i paraqesin kërkesën Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të regjistruar shoqërinë si person juridik. Në ditën e regjistrimit shoqëria fiton dhe personalitetin juridik.²⁸

Marrëveshja e ortakëve është akti (veprim juridik siç e trajtova me lart) me anë të së cilit ata bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike, duke dhënë kontribute në shoqëri. Ky akt krijimi (themelimi) nëse mund ta quajmë të tillë, është një veprim juridik dhe sipas përkufizimeve të nenit 79 të Kodit Civil është një shfaqje e vullnetit të ortakëve për të krijuar ndryshuar ose shuar marrëdhënie juridike civile.

Kjo shprehje e vullnetit mund të përfshijë dy ose më shumë persona, në këtë rast është veprim **juridik i dyanshëm** dhe në anën tjetër kemi shoqërinë me një ortak që mund të konceptohet si **një veprim juridik** i njëanshëm.

Ligji i ri për shoqëritë tregtare hesht në lidhje me formën e marrëveshjes, ndaj konkluzioni që arrihet është që marrëveshja mund të marrë çdo formë të lejuar nga Kodi Civil, neni 80, pra me shkrim, me gojë, ose me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.

Kjo është një risi e ligjit të ri pasi sipas ligjit të vjetër, siç është përmendur dhe më lart, akti i themelimit dhe statuti si dhe gjithë aktet që depozitoheshin në regjistrat duhet të vërtetoheshin si autentike nga noteri. Gjithashtu të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Kodi Tregtar i Zogut.

Nëse i referohemi legjislacioneve të huaja, përsëri këto akte duhet të jenë akte autentike dhe vërtetohej origjinaliteti i tyre nga noteri.

Në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes në ligj thuhet se ortakët “bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri sipas përcaktimeve në statut”.

Ky formulim përsëri paraqitet ndryshe nga ligji i vjetër si dhe nga Kodi Tregtar i Zogut, pra nuk kemi vazhdimësi në kuptimin historik.

Së pari, në këtë formulim nuk flitet, siç e trajtova dhe më lart, për qëllim që kanë palët për të arritur fitimin, që është dhe qëllimi kryesor i themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Gjithashtu, ka vështirësi në lidhje me shoqërinë me një ortak (që ligji e parashikon) mënyrën se si aplikohet kjo dispozitë. Kjo shoqëri është e formuar me një deklaram të njëanshëm (çka u trajtua me sipër) të vullnetit dhe shprehja “për arritjen e objektivave të përbashkëta” nuk ka kuptim.²⁹

Edhe nga ana tjetër, në rastin e themelimit të një ShPK me kapital 100 lekë, dhe pa kontribute të tjera nga ortakët, qëllimi i arritjes së objektivave të përbashkët **duke dhënë kontribute**, është pa efekte.³⁰

Gjithsesi, duke interpretuar nenin e mësipërm në bazë të së drejtës tregtare të zbatuar në vendet e BE mendoj se formulimi i nenit 3(1) të LTSHT është siç u trajtua dhe më sipër. Ky nen thekson faktin se formimi i një shoqërie është një **akt juridik** pra ka natyrë kontraktuale. Në të kemi:

- pëlqimin e palëve - kur ligji thotë “bien dakord”;

²⁸ Neni 2 dhe 3 i 9901/2008.

²⁹ Autor Bachner, Th. Schuster, F E. Winner, M. *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* pg.90

³⁰ Autor Bachner, Th. Schuster, F E. Winner, M. *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* pg.180

- qëllimin - ushtrimin e një aktiviteti ekonomik të përbashkët;
- detyrimet - dhënien e kontributeve;
- statutin që rregullon marrëdhëniet midis ortakëve, ortakëve dhe administratorëve, organizimin e ShPK etj.

Por neni 3 nuk përcakton nëse statuti i ShPK përfshihet në aktin juridik të krijimit të shoqërisë. Duke shkuar më tej, në ligjin për QKR parashikohet dhe regjistrimi i një ShPK pa një statut me shkrim.³¹ Kjo vetëm nuk është e këshillueshme nga ana juridike, por personalisht mendoj se çdo pikë e marrëveshjes së ortakëve për themelimin e një ShPK duhet të përfshihet në statut me shkrim, dhe jo në një marrëveshje deklarata me gojë.³²

Sigurisht me arritjen e marrëveshjes midis ortakëve për krijimin e shoqërisë, shoqëria nuk është krijuar ende, janë hedhur vetëm themelet për krijimin e një organizmi të ri. Aspekti i shoqërisë si një organizëm më vete është vërtet interesant sepse ka lidhje me kompleksitetin dhe sjelljen e shoqërisë si një organizatë. Momenti i themelimit nuk përmbyll interesat e palëve por është në funksion të një aktiviteti ekonomik që do kryhet, nga i cili palët shpresojnë të arrijnë përfitime dhe për zhvillimin e të cilit japin kontribute në shoqëri. Objekti i marrëveshjes/ i rënies dakord midis themeluesëve është për zbatim në të ardhmen. Marrëdhënia që ndjek marrëveshjen e themelimit është për efekt të thelbit të saj, një marrëdhënie që zgjat, dhe që kërkon mbi të gjitha për zbatimin e saj, përcaktimin të mëtejshme të vullnetit të palëve.³³

Kështu aktiviteti i shoqërisë është përcaktuar në aktin e themelimit apo statutin në mënyrë të përgjithshme, ndaj që të zhvillohet ky aktivitet ka nevojë për akte të tjera konkrete që kanë lidhje me të, dhe që realizohen hap pas hapi.

Duhet mbajtur parasysh se gjendja në të cilën shoqëria është krijuar me aktin e themelimit apo statutin mund të ndryshoj me kalimin e kohës, çka do të sjellë një ndryshim të statutit p sh hyrja e ortakëve të rinj, rritja e kontributit, ndryshimi i aktivitetit tregtar etj. Kjo situatë mund të jetë shumë e shpeshtë, dhe mund të parashikohet prej vetë ortakëve në aktin e krijimit/statutit për të lehtësuar ndryshimin, duke ja lënë vullnetit të shumicës.

Kështu nga kontrata e krijimit të shoqërisë lind një detyrim midis ortakëve në funksion të aktivitetit që do zhvillohet, krijohen kompetenca, të drejta, detyrime, dhe në rastet e përcaktuara nga palët ose ligji vlen rregulla se vullneti i shumicës vlen si vullneti i të gjithëve ose me saktë është i detyrueshëm për të gjithë. Përmes të këtij vullneti ka një grup të organizuar, dhe ky grup ekziston pavarësisht nga destinimin i të mirave të kontribuar nga palët për zhvillimin e aktivitetit.³⁴

Shoqëritë jo vetëm kanë organe për administrimin dhe kontrollin (sidomos shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe ato aksionare) por rregulli i shumicës në formimin vullnetit të shoqërisë ka zbatim të përgjithshëm në lidhje me zhvillimin e marrëdhënies shoqërore.

Ligji shkon me tutje duke i lejuar shumicës ose me saktë një shumicë të caktuar për të modifikuar **rregullimin origjinal** për të përshtatur me kërkesat konkrete të kohës apo të aktivitetit të shoqërisë. Organizmi i shoqërisë parë në këtë

³¹ Neni 28(4) i Ligjit për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit

³² Sa më sipër është dhe një rekomandim i autorëve të botimit Ligj i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane pg. 97. Thomas Bachner, Edmund-Philipp Schuster, Martin Einner

³³ Ferrara. F. Jr, Corsi. F, Gli imprenditori e le societa pg. 239

³⁴ Ferrara. F. Jr, Corsi. F, Gli imprenditori e le societa pg. 241

vështrim merr një vitalitet dhe autonomi, duke modifikuar atë kontrate, akt krijimi apo statut, apo aplikim fillestar nga i cili ka origjinën.

Sa më sipër bën që disa autorë të shmangin rëndësinë e kontratës së themelimit, duke i dhënë vlerë vetëm organizimit të krijuar. Sipas tyre funksioni i kontratës së themelimit mbaron me krijimin e shoqërisë si organizëm. Shoqëria njëherazi e krijuar ka kompetencat e saj normative që nuk lidhen me kontratën/statutin e themelimit, “kontrata sjell personalitet, por ky, njëherazi bere i gjalle, rregullohet me ligjet e vete”.³⁵

Sa më sipër ka disa që mendojnë se ortakët krijojnë shoqërinë por me fitimin e personalitetit juridik shoqëria ju del nga duart, duke pasur një autonomi dhe jetë të sajën.

Është e vërtetë që me krijimin e shoqërisë marrëdhënia nuk është më midis ortakëve por midis shoqërisë dhe secilit prej ortakëve. Gjithashtu, është e vërtetë që marrëdhënia fillestare e krijuar nga ortakët në të gjitha shoqëritë me personalitet juridik mund të ndryshohet nga shumica e ortakëve në kundërshtimin me vullnetin e ortakut ose ortakëve në pakicë. Ligji rregullon shoqërinë organizatë në mënyrë relativisht autonome nga akti i themelimit apo statuti në mënyrë që të prodhohen efektet e duhura për palët (shumicën) kur ndryshojnë kushtet, ndaj dy aspektet kontratë/dhe organizëm janë të diferencuara dhe të ndara në kohë.

Megjithatë, ka një pjesë të aktit të themelimit/statutit që mbeten të pandryshuara në kohë, siç janë qëllimi i fitimit, e drejta e rimbursimit të kuotës (përveçse rastit kur përjashtohet ortakut) etj. Sa më sipër është e lidhur ngushtë me parimin e përgjithshëm se ortakët, në të gjitha llojet e shoqërive, duhet që marrëdhëniet e tyre dhe sjelljen e tyre në asamblenë e ortakëve ta kenë të lidhur me parimin e mirëbesimit, pra te veprojnë me mirëbesim, parimi i parashikuar shprehimisht në nenin 14 të ligjit sipas të cilit gjatë ushtrimit të të drejtave ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë.

Lindja e shoqërisë si person më vete vjen në një moment të dytë, pasi të shikohet nga organet përkatëse, në rastin tonë nga QKR, ekzistenca e kërkesave ligjore dhe kushteve të caktuara nga ligji për lindjen e një shoqërie. Pra, midis hartimit të aktit juridik (me shkrim ose jo) dhe krijimit të shoqërisë ka një hapësirë kohore, gjatë të cilës shoqëria nuk ka lindur ende por është krijuar mundësia për lindjen, themelimin e saj.

Që të kemi një subjekt të ri në qarkullimin civil, pra lindjen e një personi të ri, kemi një fazë të dytë, që është regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Regjistrimi përbën një kusht provueshmërie për kontratën (*condicio juris*) për ekzistencën e shoqërisë.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar hyn në ato subjekte që, si në bazë të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ashtu dhe në bazë të ligjit për QKR detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar që të fitojnë personalitet juridik.

Që nga ky moment ne kemi të bëjmë me një organizëm që ka burimin e tij, origjinën e tij nga marrëveshja e ortakëve por nga ana tjetër ka dhe një jetë relativisht të ndarë nga kjo marrëveshje.

Marrëveshja për krijimin e shoqërisë, qoftë kjo me gojë ose e pasqyruar në atë që ligji e quan statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, është guri i themelit për shoqërinë e sapokrijuar. Në të njëjtën kohë, siç e thamë më lart, marrëveshja e pasqyruar në statut është kontratë në kuptimin e nenit 659 të Kodit Civil, por ka natyrë të veçantë.

³⁵ Mossa F. Societa commerciale personali pg. 185

Fillimisht statuti i lidh ortakët në një detyrim ose më saktë përcakton të drejta dhe detyrime për ta. Pas regjistrimit, vetë shoqëria bëhet palë në kontratë pasi fiton personalitet juridik dhe është një entitet me vete (dhe në rastin e shoqërisë me një ortak).

Për më tepër, pas regjistrimit në shoqëri mund të hyjnë ortakë të tjerë, të largohen ortakët themelues etj, që arrihet kur shiten kuotat që zotërohen në shoqëri.

Thelbi i kontratës/marrëveshjes konstitutive të mishëruar në statut është se ajo rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve të saj, ndërmjet vetë ortakëve, ndërmjet ortakëve dhe administratorëve etj. Nga kjo rrjedh dhe fakti se qënia palë në kontratën konstitutive është e lidhur ngushtë me statusin juridik e të qenit ortak.

Në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar nuk parashikohet që ndryshimi i kontratës konstitutive të mishëruar në statut të kërkojë miratimin e njëzëshëm të ortakëve themelues. Dhe kjo është e kuptueshme sepse, për aq kohë sa ligji parashikon kalimin e lirë të kuotave për ShPK (dhe kalimi i lirë i kuotave nënkupton dhe ndryshimin e përbërjes e palëve) pra dhe të ortakëve themelues të shoqërisë që kanë marrë pjesë në kontratën konstitutive të shoqërisë.³⁶

Megjithatë, statuti mund të vendosë kushte për kalimin e kuotës, p.sh. miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes së saj. Gjithashtu, dhe për ndryshimet e mëtejshme të statutit të ShPK ligji parashikon se mund të ndryshohet me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës. Por, përsëri ligji i lë fushë të lirë ortakëve që të parashikojnë një shumicë dhe më të lartë në statutin e miratuar prej tyre.³⁷

Statuti i çdo shoqërie duhet të përmbajë të dhëna të caktuara që përkufizojnë identitetin e shoqërisë. Ligji i ri për tregtarët e shoqëritë tregtare mund të thuhet se nuk bën rregullimin e të dhënave që duhet të përfshihen në statutin e çdo shoqërie, nuk ka parashikime të veçanta por vetëm një dispozitë referuese. Kështu ligji bën një citim të thjeshtë në nenin 6 të tij, duke të çuar tek nenet 32 deri 36 të ligjit për QKR, pra një dispozitë referuese.

Si të dhëna themelore për regjistrimin e një shoqërie, të cituara në nenin 32 të ligjit për QKR ,renditen:

- Emri.
- Forma e shoqërisë.
- Data e themelimit.
- Të dhëna për identitetin e themeluesve.
- Qendra ose zyra qendrore, nëse është caktuar.
- Kohëzgjatja, nëse është vendosur.
- Të dhëna për identitetin e personave përgjegjës për administrimin e shoqërisë.
- Kompetencat e tyre.
- Kohëzgjatja e mandatit si dhe mostra të nënshkrimit të përfaqësuesve.³⁸

³⁶ Autor Bachner, Th. Schuster, F E. Winner, M. *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* pg. 99.

³⁷ Neni 73 i Ligjit 9901/2008

³⁸ Neni 32 e 35 i Ligjit per QKR

✓ **Emri dhe forma.**

Emri i shoqërisë renditet si e dhëna e parë e rëndësishme. Krijohet një person i ri juridik i cili do të hyjë në qarkullimin civil dhe që të identifikohet i duhet patjetër një emër. Ortakët janë të lirë të zgjedhin emrin që duan, mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë, vetëm duhet ti regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duhet të përmbajë shkurtimin përkatës, që tregon se është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, formën e zgjedhur nga ortakët, pra "ShPK"

✓ **Data e themelimit.**

Në lidhje me datën e themelimit, për mendimin tim, është data e nënshkrimit të statutit ose aplikimit për regjistrim fillestar pasi data e themelimit nuk mund të dihet. Ortakët mund të kenë rënë dakord për krijimin e një shoqërie dhe muaj më përpara se të ndërmarrin hapat e kërkuar nga ligji për regjistrimin.

✓ **Identiteti i themeluesve.**

Në lidhje me të dhënat për identitetin e themeluesve dispozita paraqitet pak problematike, pasi mund të lindë diskutimi nëse emri dhe mbiemri janë të dhëna të mjaftueshme. Për mendimin tim, tek të dhënat e themeluesve, ortakëve, duhet të përfshihen emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi dhe nënshitetësia.

✓ **Qendra ose zyra qendrore e shoqërisë.**

Qendra e shoqërisë është vendi ku ushtrohet aktiviteti tregtar ose pjesa kryesore e tij. Ligji e lë në vullnetin e ortakëve që të përcaktojnë se ku do e këtë qendrën shoqëria. Ortakët janë të lirë të vendosin se ku do të jetë qendra e saj, por dhe mund të mos e përcaktojnë fillimisht. Në nenin 32 të ligjit për QKR selia hyn tek të dhënat e detyrueshme për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare në përgjithësi dhe të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në veçanti, ndaj ortakët fillimisht mund të përcaktojnë si seli të shoqërisë njëri prej adresave të tyre të vendbanimit deri në përcaktimin e saktë të selisë së saj.

✓ **Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë, e jetës së saj, hyn tek ato të dhëna që ligjvënësi i ka konsideruar të rëndësishme. Dhe kjo ka lidhje dhe me faktin se plotësimi i kohëzgjatjes së shoqërisë përbën shkak për prishjen e shoqërisë direkt nga forca e ligjit, pra *ipso iure*. Nëse kjo kohëzgjatje është e përcaktuar, hyn tek të dhënat e detyrueshme.

✓ **Identiteti i personave përgjegjës për administrimin e shoqërisë.**

Tek këto të dhënat unë personalisht mendoj se duhet të përfshihen emri, mbiemri, vendlindja, ditëlindja, vendbanimi dhe nënshtetësia.

✓ **Kompetencat e administratorëve.**

Do ishte në interes të shoqërisë, por dhe të ortakëve, që kompetencat e administratorëve të jenë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në statut, sidomos në rastet kur ka më shumë se një administrator.

✓ **Kohëzgjatja e mandatit si dhe mostra të nënshkrimit të përfaqësuesve.**

Në ligj është parashikuar se administratorët caktohen për një afat tre vjeçar. Në rast se ortakët vendosin që ky mandat të jetë më i shkurtër se tre vjet, atëherë ky vendim duhet të regjistrohet si një e dhënë që ligji e konsideron të rëndësishme. Gjithashtu, në regjistrin pranë QKR depozitohen dhe mostra të nënshkrimit të përfaqësuesve.

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar janë të detyrueshme dhe:

- njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar;
- numri i pjesëve të kapitalit themeltar;
- vlera nominale e secilës pjesë;
- pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak;
- si dhe informacioni nëse kapitalit fillestar i nënshkruar është paguar ose jo.

Të dhënat e mësipërme janë të detyrueshme nëse ortakët kanë vendosur që të themelojnë një shoqëri me kontribute, por mund të ndodhë që ortakët të krijojnë një ShPK me kapital 100 lekë, atëherë a ka efekte dispozita e mësipërme? A është e aplikueshme ajo?

Në fakt doktrina mban qëndrimin se nuk ka shoqëri pa kontribute dhe nuk mund të jesh ortak nëse nuk ke kontribuar. Por ligji ynë ka lejuar në nenin 70 të tij, që shoqëria me përgjegjësi të kufizuar të krijohet dhe me 100 lekë si kapital ligjor. Sa më sipër kjo shumë do të konsiderohet dhe si kontribut i ortakëve.

Në shumë vende të Evropës perëndimore nuk ka një rregull që të urdhërojë një shumë të caktuar kapitali për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara. Ka lidhje pikërisht me Direktivën e parë të komunitetit evropian, të miratuar në datën 9 mars 1968, no. 68/151/EEC, e cila konsiderohet si Direktiva e parë që hodhi themelet e lirisë së themelimit (*freedom of establishment*). Ajo, megjithatë, ka pësuar ndryshime të shumta.

Kjo direktivë është e zbatueshme për llojet e shoqërive në të gjitha shtetet anëtare, sepse në momentin që u miratua ishte me rëndësi çështja e heqjes së kufizimeve në lidhje me lirinë e themelimit, sidomos me shoqëritë aksionare apo

shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, pasi këto shoqëri po e shtrinin aktivitetin tyre dhe përtej kufijve kombëtarë, ndaj dhe neni 70 i ligjit të ri ndjek këtë prirje³⁹.

Pyetja që lind pas trajtimit shkurtimisht të këtyre të dhënave që ligji ka parashikuar si të detyrueshme, është nëse i gjithë ky informacion duhet të përfshihet në statut apo jo?

Si fillim mendoj se të dhënat e identitetit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin, kohëzgjatjen e mandatit të tyre (nëse është më e shkurtër nga çfarë ka parashikuar ligji), si dhe kampionet e nënshkrimeve të përfaqësuesve janë çështje që do ishte mirë të përfshihen në statut.

Nga njëra anë kjo duket problematike, pasi çdo emërim i administratorëve do të kërkonte ndryshim statuti dhe si të tillë, mbledhje asambleje dhe vendim me $\frac{3}{4}$ të votave të ortakëve që marrin pjesë. Megjithatë, në bazë të rregullit të përgjithshëm të LTSHT, administratorët e ShPK emërohen nga asambleja e ortakëve me shumicë të thjeshtë.

Në lidhje me kompetencat e individëve që do të përfaqësojnë shoqërinë, është mirë të përfshihen në statut, por përsëri do të lindë problemi në rast se ortakët do të donin ndryshime të këtyre kompetencave pasi përsëri do të kërkohej ndryshimi i statutit.

P.sh., në rastin e shoqërisë me më shumë se një administrator, a duhet miratimi i të gjithë administratorëve për të lidhur kontratë kredie me bankën apo vetëm miratimi i njërit prej tyre? Ose, nëse njëri nga administratorët vendos të shesë pasuri të shoqërisë nën vlerën 5 %, a duhet miratimi i administratorëve të tjerë?

Sa më sipër, parashikimet e detajuara janë, në fakt, në interes të vetë ortakëve të shoqërisë si pronarë të saj, por dhe të vetë shoqërisë si person juridik më vete dhe i ndarë nga ortakët. Megjithatë, nëse ortakët do të kishin probleme në lidhje me ndryshimet e mëtejshme të statutit, një rekomandim do ishte që të përfshihen disa rregulla të përgjithshme për kompetencat e përfaqësimit të administratorëve.

Një problem i ngjashëm lind në lidhje me dispozitën e nenit 35 të ligjit për QKR, sipas të cilës në regjistrimin e ShPK duhet të përfshihen njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, si dhe informacioni nëse kapitali themeltar është i paguar ose jo. Nga neni 43 i ligjit për QKR rrjedh se çdo ndryshim i ortakëve në shoqëri duhet të regjistrohet dhe neni 26/3 i ligjit për QKR përmban një dispozitë të posaçme, që aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike që lidhen me pjesëmarrjet në kapital, kuotat etj., mund të kryen gjithashtu dhe nga ortaku të cilit i përkasin. Por, nuk gjendet asnjë dispozitë në LTSHT që veprimet juridike që lidhen me kuotat në ShPK kërkojnë ndryshim statuti ose duhet të depozitohen. Përkundrazi, ky rregull do të binte ndesh me parimin e kalimit të lirë të kuotave në ShPK, përveç rastit kur statuti parashikon shprehimisht që kalimi i kuotave kushtëzohet nga miratimi i shoqërisë (neni 73/3i LTSHT që duket se është ligjërish e mundshme, por sigurisht që nuk do të rekomandohej një kushtëzim i tillë i vështirë në kuadrin e direktivave të KE).⁴⁰

Gjithashtu, ligji ka parashikuar rastin e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar pa statut me shkrim, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrimin fillestar.

³⁹ Ky përcaktim si dhe mbajtja e regjistrimit tregtar në format elektronik i, publikimi i te dhënave, etj ka të beje pikërisht me implementimin e te drejtës komunitare në legjislacion tone dhe i përmbahet konkretisht direktivës se pare te BE .

⁴⁰ Thomas Bacher, Edmund Philipp Schuster, Martin Winner. Ligji i ri shqiptar për të drejtën e shoqërive tregtare. (interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane fq 101

Kështu, neni 28/4 i ligjit për QKR parashikon se:

“Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklaratata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.”

Kjo dispozitë që përmendet në nenin 6 të ligjit për LTSHT, ku thuhet se ky paragraf është i zbatueshëm, bazohet në idenë se të gjitha këto të dhëna që do të përmbahen në aplikimin për regjistrimin fillestar në QKR mund të zëvendësojnë statutin e shoqërisë ose aktin e themelimit.

Duket sikur mënjanohet statuti si akt i shoqërisë por në fakt aplikimi për regjistrim fillestar nënshkruhet nga të gjithë ortakët e ShPK si dhe përmban të dhëna të tilla që si rregull përfshiheshin në statutin e shoqërisë. Pra, vullneti i ortakëve si dhe të dhëna tejet të rëndësishme për jetën e shoqërisë parashikohen në aplikimin për regjistrimin fillestar dhe mund të thuhet pa mëdyshje se ky aplikim zëvendëson kontratën ose statutin e shoqërisë.

Personalisht jam kundër regjistrimit të shoqërisë me anë të aplikimit fillestar për regjistrimin pa statut me shkrim. Mendoj se statuti i shoqërisë duhet të jetë një akt i plotë dhe me vete, kjo për faktin se vet marrëdhëniet e shoqërisë me ortakët, e ortakëve midis tyre, dhe ortakëve dhe administratorëve, e shoqërisë me administratorët por dhe me të tretët do jenë me pak konfliktuale nëse do të ketë një akt të detajuar me shkrim mbi të cilin do bazohen.

❖ REGJISTRIMI NË QKR

Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit bëhet në një regjistër tregtar në format elektronik.

Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave të njoftuara dhe të depozituara në regjistër kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar (ligji për QKR).

Gjithashtu, QKR ruan dhe arkivon aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.

Në ligjin për QKR dhe pikërisht tek formati elektronik tek mënyra dhe ruajtja e të dhënave duket qartë pasqyrimi dhe implementimi i direktivës së parë të BE, e cila në kohën kur u miratua por dhe me ndryshimet që ka pësuar, ka synuar koordinimin e dispozitave kombëtare në lidhje me hapjen e shoqërive, vlefshmërinë e pavlefshmërinë e detyrimit e marra përsipër, dispozita këto që marrin një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e interesave të personave të tretë.

Ideja që theksohet në këtë direktivë është mbrojtja e interesave të personave të tretë duke iu bërë të njohur atyre gjithë informacionin e nevojshëm të shoqërisë që po krijohet, sidomos në lidhje me personat e autorizuar për themelimin e shoqërisë. Nenet e kësaj direktive janë të nevojshme për të siguruar qartësinë në ligj në lidhje me marrëdhëniet midis shoqërisë dhe personave të tretë, midis vetë anëtareve të shoqërisë, të kufizojnë rastet e pavlefshmërisë dhe efektet e deklarimit të pavlefshëm të krijimit të shoqërisë.

Nga kjo direktivë ka buruar detyrimi për shtetet anëtare për të krijuar një regjistër qendror, regjistër tregtar ose regjistër të shoqërive, për çdo shoqëri të regjistruar, ku duhet të pasqyrohen të gjithë dokumentet e nevojshme të kërkuara për hapjen e shoqërive. Kjo direktivë vendos detyrimin që të gjitha dokumentet të cilat duhet të pasqyrohen në regjistrat përkatës të jenë edhe në formë elektronike përveç se në formë dokumenti.⁴¹

Në këtë linjë është dhe ligji ynë për QKR, ligje të miratuara në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe përshtatjes së legjislacionit tonë me *acquis communautaire*.

Regjistrimi sipas ligjit tonë në QKR kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese që provojnë të dhënat që do regjistrohen. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin, duhet të jenë në gjuhën shqipe, etj. Ligji parashikon rregulla të specifikuar për paraqitjen e akteve private të huaja si dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja.

ShPK si shoqëri tregtare regjistrohet në regjistrin tregtar duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar të shoqëruar me statutin e aktin e themelimit nëse këto janë hartuar si dokumente të veçanta. Pra, sipas këtij ligji, statuti dhe akti i themelimit mund të jenë dhe në një akt të vetëm.

Këtyre akteve u bashkëngjiten aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme. Në ligj (neni 28 i ligjit për QKR) parashikohet se ShPK, mund të regjistrohet duke depozituar dhe vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, dokumentet e identifikimit të ortakëve si dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe

⁴¹ (Ky rregullim është bërë nga ana e Direktivës së Këshillit Nr. 2006/99/EC e 20 Nëntorit 2006, sipas të cilës Shtetet Anëtare nga 1 Janari 2007, të gjitha dokumentet e kërkuara për regjistrimin e shoqërive duhet të depozitohen edhe në formë elektronike).

zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin e funksionimin e llojit të shoqërisë që po regjistrohet (u trajtua me lart).

Bashkëngjitur do paraqes një model aplikimi fillestar për regjistrimin si person juridik të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar si dhe një model statuti të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Këto modele do jenë në aneksin 1 dhe 2 të kësaj teme.

KAPITULLI I DYTË

ORGANET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

- **Asambleja si organ i shoqërisë. Kufizimet e kompetencave të asamblesë.**
- **Mënyrat e thirrjes.**
- **Vendimmarrja dhe kundërshtimi i vendimeve të asamblesë.**
- **Administratorët.**
- **Marrëdhënia e administratorëve me asamblenë.**
- **Emërimi dhe shkarkimi.**
- **Kompetencat e administratorëve.**
- **Përgjegjësitë e administratorëve.**

❖ ORGANET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË PËRGJITHËSI

Organizimi i brendshëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar parashikohet në titullin IV, kreu i parë, i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas kësaj pjese të ligjit shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka disa organe dhe secili prej këtyre organeve ka kompetencat e tij.

Ortakët përbëjnë një prej këtyre organeve, të ashtuquajturën asambleja e përgjithshme.

Krahas këtij organi kemi dhe një tjetër organ shumë të rëndësishëm për jetën e shoqërisë, administratorët, organ që mund të përbëhet prej ortakësh ose jo.

Kompetencat e këtyre dy organeve shpesh nuk janë të ndara në mënyrë të prerë. Këto kompetenca varen nga natyra e vetë shoqërisë se si është krijuar, nëse ka në bazë të saj një raport familjar, miqësor apo është një shoqëri me shumë ortak tipike kapitali, Gjithashtu kompetencat e këtyre organeve varen dhe nga personaliteti i subjekteve që i kanë këto kompetenca etj.

Në përgjithësi mund të themi se administratorët kanë drejtimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë dhe janë organ ekzekutiv i saj, ndërsa asambleja ka kompetencën e emërimit të administratorëve, kërkon llogari për aktivitetin e zhvilluar prej tyre, merr vendimet më rëndësishme që kanë lidhje me jetën e shoqërisë, përfaqëson shoqërinë në procedimet ndaj administratorëve etj.

Në mënyrë të përmblodhur kompetencat e këtyre organeve po i paraqes në këtë tabelë:

Administratorët	Kanë drejtimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë. Janë organi ekzekutiv i shoqërisë. Janë përfaqësues të shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët.
Asambleja	Ka kompetencën e emërimit të administratorëve. Kërkon llogari për aktivitetin e zhvilluar prej tyre. Merr vendimet më rëndësishme që kanë lidhje me jetën e shoqërisë. Pra është organ vendimmarrësi i saj.

Asambleja ka një pozicion kryesor dhe është organi sovran i shoqërisë. Jo në kuptimin që aktiviteti i saj, kompetencat e saj nuk kanë limit, por në kuptimin që anëtarësia në të, vjen si pasojë e qenies ortak, anëtarët e saj (që janë ortakët) nuk marrin emërimin nga askush, gjithashtu asambleja e ortakëve nuk i jep llogari askujt.⁴²

Administratorët janë të varur nga Asambleja, por nuk janë plotësisht nën urdhërat e saj pasi një pjesë e kompetencave të tyre janë të përcaktuar në statut, në ligj dhe në këtë mënyrë ata janë të detyruar të respektojnë dispozitat përkatëse dhe kundër vullnetit të asamblesë së ortakëve. Në këtë aspekt ky organ i varur, përbën një frenimin të pozitës të fortë që ligji i ka dhënë asamblesë së ortakëve. Nëse asambleja e ortakëve kërkon të konsumojnë veprime të paligjshme me qëllim për të pasur më shumë fitime, nuk mund të gjejë terren për ta realizuar këtë pasi janë administratorët ata që do mbajnë përgjegjësi.

Administratorët janë në fakt organet përgjegjëse për aktivitetin e shoqërisë, sidomos penalisht, ndaj dhe si organ ata përfaqësojnë një filtër për aktivitetin e asamblesë së ortakëve, duke çuar përpara vetëm atë që është në përputhje me ligjin.⁴³ Të dy këto organe janë të domosdoshme dhe jo vetëm që janë parashikuar në ligj, në nenet 81 asambleja e ortakëve dhe neni 95 administratorët por dhe shumica e kompetencave të tyre janë të përcaktuara në ligj dhe në statut. Sigurisht që statuti mund të bëjë rregullime të ndryshme të kompetencave të asamblesë ose administratorëve por këto ndryshime duhet të jenë brenda kornizës që ligji lejon.

⁴² Traktati i GRIPPO Trattato di diritto private diretto da Rescigno Torino 1985 pg. 357

⁴³ Ferrara F Jr, Corsi F, Gli imprenditori e le società pg. 503

❖ ASAMBLEJA E ORTAKËVE SI ORGAN I SHOQËRISË

Asambleja e përgjithshme është mbledhja e të gjithë ortakëve të shoqërisë me qëllimin për të shfaqur vullnetin e shoqërisë. Është ndërgjegjia e ortakëve për të vepruar (punuar) në funksion të shoqërisë që e cilëson mbledhjen si asamble.

Mund të ndodhë që të gjithë ortakët të mblidhen rastësisht e të bien dakord të punojë për shoqërinë (të marrin vendime për shoqërinë) d.m.th. të jenë asamble, pra organ i shoqërisë. Ligji ynë e njeh indirekt këtë situatë në nenin 83 të tij. Në këtë nen parashikohet se nëse asambleja nuk është thirrur sipas procedurës të parashikuar shprehimisht në ligj, ajo nuk mund të marr vendime të vlefshme. Por aman nëse të gjithë ortakët bien dakord të marrin vendime (d.m.th. të punojnë për shoqërinë), pavarësisht parregullsisë në thirrje e saj, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme.⁴⁴

Por nëse ndodh të kemi mbledhje asamble dhe nuk marrin pjesë të gjithë ortakët, duhet që mbledhja të jetë thirrur sipas një procedure të caktuar.

Sipas kësaj procedure ortakët duhet të jenë thirrur për të shfaqur vullnetin pasi të jenë përmbushur disa kushte si më poshtë:

- Çështjet që do të diskutohen të jenë përcaktuara më parë.
- Mbledhja të bëhet në vendin, datën dhe orën e caktuar.
- Për rendin e ditës ortakët duhet të jenë njoftuar 7 ditë më parë.⁴⁵

Vetëm në këtë mënyrë mbledhja mund të marrë vendime të vlefshme.

Sipas ligjit tonë (neni 87) asambleja e ShPK vendos me shumicë votash, madje kuoromet kanë ndryshuar shumë nga ligji i mëparshëm, janë shumë më të ulëta. Duke ndjekur këtë logjikë duket sikur mjafton të njoftohen ortakët që kanë shumicën në kapitalin e shoqërisë dhe në këtë mënyrë vendimi i marrë do të jetë shprehje e vullnetit të shoqërisë. Në bazë të nenit 83/1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” situata është ndryshe, njoftimi ju drejtohet të gjithë ortakëve dhe të gjithë thirren për të marrë pjesë në mbledhje.

Ligji lejon që të gjithë ortakët të marrin pjesë në mbledhje, të shprehin mendimet dhe vullnetet e tyre, dhe në fund vullneti i shoqërisë do jetë vërtet vullneti i ortakëve që kanë shumicën në kapitalin e shoqërisë. Rëndësi ka që asambleja të thirret rregullisht sipas procedurës së parashikuar në ligj.

Asambleja është realisht “organi më i lartë” i shoqërisë për shkak të kompetencave të saj për të miratuar, ndryshuar, modifikuar statutin e shoqërisë. Ligji i cakton një pozitë të fortë asamblesë së ortakëve, si i vetmi organ i cili në mënyrë direkte emëron apo shkarkon organet drejtuese të shoqërisë pra administratorët e saj. Megjithatë, asambleja ka disa kufizime në veprimtarinë e saj. Kështu është e detyruar të respektoj normat ligjore në lidhje me strukturën e shoqërisë, me funksionimin e saj si dhe interesat e ortakëve në pakicë.

Duke u ndalur tek interesat e ortakëve në pakicë ligji ka parashikuar shprehimisht të drejtat e tyre në nenin 84 të tij.

Ligji ka parashikuar se ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund të kërkojnë thirrjen e asamblesë së ortakëve. Për këtë ata i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Ligji ka parashikuar se për këtë pakicë mund të përdor dhe postën elektronike. Kërkesa duhet

⁴⁴ Neni 83 i ligjit 9901/2008

⁴⁵ Neni 83/1 I ligjit 9901/2008

të jetë e arsyetuar, ajo duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim.

Nëse ndodh që administratorët të refuzojnë kërkesën e ortakëve të pakicës atëherë ata kanë të drejtë të thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej ortakëve të pakicës nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën ka të drejtë:

- të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Doktrina ka trajtuar gjerësisht mbrojtjen e të drejtave të pakicës por për shoqëritë aksionare. Megjithatë ka dhe disa trajtime juridike për ShPK.

Dispozita e mësipërme është pasqyrim i kësaj tendence dhe në ligjin tonë. Në rastin e mbrojtjes së ortakëve të pakicës në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara mund të zbatohen të njëjtat rregulla si për shoqërinë aksionare për aq kohë sa dhe ShPK është një shoqëri kapitali.

Shumë ortakë në shoqëritë e kapitalit nuk duan të jenë aktivë në administrimin e shoqërisë por thjesht investitorë. Megjithatë, kontrolli përfundimtar i shoqërisë qëndron tek asambleja e ortakëve pra tek ortakët ose më saktë tek ortakët që kanë shumicën.

Parimi i përgjithshëm është se të gjithë ortakët kanë të drejtën e votës për aq sa kjo votë nuk është objekt i ndalimeve të parashikuara në ligj apo statut. Një ortak që ka të drejtën e votës mund ta ushtrojë këtë të drejtë sipas dëshirës qoftë dhe në kundërshtim me interesin e shoqërisë.

Ortakët mund të bien dakord për të kufizuar ose përcaktuar mënyrën në të cilën ata do të ushtrojnë të drejtën e votës. Si rregull, ortakët e ushtrojnë të drejtën e votës në mbledhjen e asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Mbledhja e asamblesë se përgjithshme rregullohet posaçërisht nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ligji, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit. Gjithashtu, mbledhja e asamblesë bëhet në të gjitha ato raste kur është nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” mund të them se janë katër lloj mbledhjesh të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Ky kategorizim ose kjo ndarje është bërë prej meje duke studiuar dispozitat e ligjit 9901/08 dhe pikërisht nenet 82 e 84 të tij. Llojet e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë janë si më poshtë:

1	Mbledhja e përgjithshme vjetore
2	Mbledhje të jashtëzakonshme
3	Mbledhje që i përkasin një klase të caktuar ortakëve (pakica)
4	Mbledhje të zakonshme

1. Kategoria e parë e mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.

Ligji parashikon se asambleja e përgjithshme duhet të mbledhet të paktën njëherë në vit në një mbledhje të përgjithshme të ortakëve.⁴⁶

Mbledhja vjetore e asamblesë së përgjithshme është parashikuar në ligj në mënyrë që të kemi një aktivitet normal të shoqërisë.

Në këtë mbledhje duhet të miratohen bilancet vjetore, të merren e vendimet për pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së shoqërisë, shpërndarja e fitimeve vjetore etj.

2. Kategoria e dytë e mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.

Mbledhje të jashtëzakonshme janë ato që thirren kur ka një situatë në të cilën është e nevojshme marrja e vendimeve përkatëse nga asambleja.

Si situata të tilla ligji ka parashikuar:

- a) gjendjen e paaftësisë pagueuse në tre muajt e ardhshëm;
- b) shitjen ose disponimin në çdo mënyrë tjetër të aktiveve që përbëjnë 5 % të aseteve të shoqërisë;
- c) nëse shoqëria propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë.⁴⁷

Këto mund të konsiderohen dhe si mbledhje të jashtëzakonshme pasi kemi një situatë emergjente, shoqëria mund të jetë në prag falimentimi, do shes ose disponojë aktive të saj, ose do blejë nga ortak pra që mund të jenë dhe raste të konfliktit të interesave.

3. Kategoria e tretë e mbledhjeve të asamblesë së ortakëve.

Në këtë kategori mbledhjesh hyjnë ato të thirrura nga ortakët e pakicës dhe të trajtuara pak më lart.

Këto mbledhje janë trajtuar në nenin 82/2 dhe 84 të ligjit Për tregtarët e shoqëritë tregtare.

4. Kategoria e katërt e mbledhjeve të asamblesë.

Janë mbledhjet e zakonshme, që kanë të bëjnë me vendimmarrje të ndryshme të asamblesë së ortakëve, vendimmarrje që mund të lindin gjatë zhvillimit normal të aktivitetit të shoqërisë, që mund të çojnë dhe në ndryshime të statutit, mund të ketë largimi ortakësh ose dhe përjashtim etj. Pra situata që kërkojnë mbledhje dhe vendimmarrja nga ana e asamblesë së shoqërisë.

⁴⁶ Neni 82/1 i ligjit 9901/08

⁴⁷ Neni 82 /3/4/5 i ligjit 9901/2008

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së ortakëve.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
2. Ndryshimet e statutit.
3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve.
4. Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
5. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike.
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
8. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
9. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
10. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
11. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
13. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë është një e drejtë themelore që ligji i ka dhënë asamblesë së përgjithshme si organ kryesor i shoqërisë. Kjo kompetence ka rëndësi shumë të madhe, sepse ndikon drejtpërdrejt në ndarjen e kompetencave midis organeve të shoqërisë pra midis asamblesë dhe administratorëve. Duke vendosur politikat tregtare të shoqërisë ortakët përcaktojnë parametrat brenda të cilëve administratorët në veçanti dhe administrata e shoqërisë në përgjithësi duhet të drejtojnë shoqërinë.⁴⁸

⁴⁸ Autor Bachner, Th. Schuster, F E. Winner, M. *Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane* pg. 139

Gjithashtu, kompetencë e rëndësishme është ndryshimi i statutit të shoqërisë, kompetencë e cila nuk mund ti përkasë asnjë organi tjetër përveç ortakëve të shoqërisë të mbledhur në asamblenë e përgjithshme.

Kompetenca të tjera janë dhe ato të përmendura më lart, si emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, përcaktimi i shpërblimeve të tyre, shpërndarja e fitimeve etj.

Risi e ligjit të ri është fakti se parashikon që asambleja e ortakëve është përfaqësuese e shoqërisë në:

- Procedimet në gjykatë.
- Procedimet ndaj administratorëve.
- Në paditë që paraqiten në gjykatë për përjashtim ortaku.

Në këtë rast asambleja paraqitet si organ i shoqërisë dhe përfaqëson atë në gjykatë. Sigurisht që asambleja mund të përfaqësohet nga njëri prej ortakëve me prokurë ose nga një avokat, por rezulton qartazi që është asambleja përfaqësuesja e shoqërisë dhe jo administratorët.

Kemi një përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm. Në rastet kur procedohet kundër administratorëve është rregulluar shumë mirë nga ligji fakti që shoqëria të përfaqësohet në gjykim nga asambleja. Nëse shoqëria do padiste administratorin dhe do të përfaqësohej nga po administratori (në rastet me një administrator) atëherë do kishim të njëjtin person në gjykim. Ligji duke rregulluar këtë pjesë ka shmangur çdo situatë konflikti në lidhje me përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë.

Më gjerësisht do ta trajtoj këtë fakt dhe tek përjashtimi i ortakut nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, parashikuar nga neni 102 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në këtë rast asambleja i kërkon gjykatës përjashtimin e ortakut.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë:

1. Vendin.
2. Datën dhe orën e mbledhjes.
3. Rendin e ditës.

Njoftimi duhet t’ju dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Fakti i njoftimit të gjithë ortakëve nominalisht është një dallim që kanë asambleja e thirrur në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar nga ato aksionare.

Gjithashtu, risi e ligjit është dhe njoftimi për mbledhje me anë të postës elektronike, por kjo lejohet nëse statuti e parashikon shprehimisht.

Sa më sipër është një pasqyrimi i zhvillimit teknologjik dhe në ligjin për tregtarët e shoqëritë tregtare.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si me sipër ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në mënyrë të përmbledhur thirrja e asamblesë bëhet sipas skemës së mëposhtme:

Autoriteti përgjegjës për thirrje	<i>Administratori</i>
Procedura e njoftimit	<i>Njoftim me shkresë</i>
Përfshirje nga procedura	<i>Njoftim në rrugë elektronike</i>
Afati i njoftimit	<i>Jo më vonë se 7 ditë përpara ditës së mbledhjes</i>
Përmbajtja e njoftimit	<i>Vendi ku do të zhvillohet mbledhja, data, ora dhe rendi i ditës</i>

❖ VOTIMI NË ASAMBLE

Procesi i votimit është shprehja e vullnetit të ortakut. Në pamje të parë votimi është ngritje dore. Ligji parashikon këto lloje votimi:

- a) Votimi personal duke qenë vetë ortakut.
- b) Votimi duke u përfaqësuar nga një ortak tjetër ose person i tretë.
- c) Votimi elektronik.
- d) Votimi me shkresë.

Votimi është personal kur ortakut është prezent në mbledhje dhe ushtron të drejtën e votës duke shprehur në mënyrë të lirshme vullnetin e tij.

Ortakut mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.⁴⁹

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Ligji ndalon administratorët e shoqërisë të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Gjithashtu, në ligjin e ri kemi disa risi në lidhje me pjesëmarrjen ortakëve në mbledhjet e asamblesë. Ligji i ka lënë mundësi ortakëve që në statut të parashikojnë alternativa të tjera pjesëmarrje në mbledhje përveç qenies të pranishëm. Kështu, statuti i miratuar nga ortakët, mund të parashikojë mundësinë e pjesëmarrjes së ortakëve në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) Transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale (skype).
- b) Komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër.

⁴⁹ Neni 85 i ligjit 9901/2008.

- c) Mekanizma që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Kjo është risi e ligjit dhe, siç u përmend më lart, është pasqyrimi i zhvillimeve teknologjike që mundëson shprehje e vullnetit në mënyrë të qartë dhe në kohë reale. Parashikime të tilla në statut janë faktor pozitiv duke çuar në një vendimmarrje sa më solide të asamblesë së ortakëve të shoqërisë dhe realizuar pjesë marrjen e tyre në mbledhje pa qenë në selinë e shoqërisë në kuptimin fizik.

Ligji përmend votimin me shkresë por nuk jep detaje për mënyrën se si mund të kryhet ky votim.

Gjithashtu në ligji nuk përcaktohet nëse shkresa do jetë me akt noterial apo shkresë e thjeshtë. Për aq kohë sa ligji nuk parashikon formë të caktuar atëherë lejohet shkresa e thjeshtë.

❖ MARRJA E VENDIMEVE

Kontrolli në shoqëri ushtrohet nga ortakët që kanë shumicë të thjeshtë të votave, përveç rasteve kur statuti parashikon ndryshe.

Është e kuptueshme se rregulli i përgjithshëm është rregulli i shumicës në vendimmarrjet e zakonshme.

Mbledhja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.⁵⁰

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.⁵¹

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet e mëposhtme:

1. ndryshimin e statutit;
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
3. shpërndarjen e fitimeve;
4. riorganizimin;
5. prishjen e shoqërisë.⁵²

Megjithatë, nga ky rregull mund të bëhen përjashtime. Në këtë rast është statuti që mund të parashikojë një shumicë më të lartë, duke vendosur shumica të tjera më të larta por dhe unanimitetin.

Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.⁵³ Por dhe këtu mund të ketë përjashtime, dhe përjashtime janë rastet kur parashikohet ndryshe në statut.

⁵⁰ Neni 86/1 i Ligjit 9901/2008

⁵¹ Neni 86/1 i Ligjit 9901/2008

⁵² Neni 87/1 i Ligjit 9901/2008

Gjithashtu, ligji ka rregulluar vlefshmërinë e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët apo ato vendime që kufizojnë të drejtat e tyre. Vlefshmëria e këtyre vendimeve kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.⁵⁴ Nëse ky miratim mungon atëherë nuk ka vlerë dhe as efekt. Përrjashtim nga ky rregull përben rasti nëse është parashikuar ndryshe në statut.

Gjithashtu, ligji ka rregulluar qartësisht dhe konfliktin e interesit duke parashikuar përjashtimi nga e drejta e votës. Qëllimi i ligjvënësimit ka qenë garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, në interesin më të mirë të mundshëm të shoqërisë dhe ortakëve të tjerë, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave vetjak të ortakut dhe atyre shoqërisë dhe ortakëve të tjerë. Kështu, neni 89 ndalon ortakun të ushtrojë të drejtën e tij të votës nëse merren vendime në të cilat ai ka një interes të tij në konflikt me atë të shoqërisë.

Kemi konflikt interesi midis ortakut dhe shoqërisë nëse ortaku gjendet në situatën e mbartësit të dy interesave të kundërt në një vendimmarrje të caktuar, interesi i tij si ortak dhe të interesit të shoqërisë nga ana tjetër. Kjo kundërshti në interesat është e tillë që ai nuk mund të realizojë njërin pa sakrifikuar tjetrin.⁵⁵

Duke u bazuar tek ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, do përpiqem të jap një përkufizim të konfliktit të interesit.

Në pamje të parë duke sikur nuk ka lidhje, por me interpretim analogjik mendoj se konflikt i interesit në rastin e shoqërisë tregtare dhe ortakut është “gjendja e konfliktit ndërmjet qenies ortak në shoqëri dhe vendimmarrjes si ortak dhe interesave privatë të ortakut si person, individë, interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në një vendimmarrjen të paanshme dhe në interes të shoqërisë por dhe ortakëve të tjerë”.

Kështu, ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.⁵⁶

Megjithatë, ligji nuk ka rregulluar ose nuk ka parashikuar se si veprohet nëse ortaku merr pjesë në mbledhje, megjithëse ekziston situatë e sipërcituar dhe vota e tij llogaritet në vendimmarrje.

Si mund të kundërshtohet vendimi i asamblesë për nullitet apo anulueshmëri?

Nëse i referohemi për analogji legjislacionit Italian është parashikuar shprehimisht kundërshtim i këtyre vendimeve. Neni 2373 i Kodit Civil Italian parashikon se vendimi kundërshtohet në bazë të nenit 2377, “nëse i ka shkaktuar dëm shoqërisë”. D.m.th. vendimi është i anulueshëm nëse rezulton dhe është evident që ortaku ka votuar në interes të tij duke sakrifikuar interesin e shoqërisë. Neni i sipërcituar nuk kërkon një dëm të pësuar eventualisht nga shoqëria por vetëm të provohet ekzistenca e rrezikut për të pësuar dëm.

⁵³ Neni 87/2 i Ligjit 9901/2008

⁵⁴ Neni 87/3 i Ligjit 9901/2008

⁵⁵ F. Galgno Diritto commerciale Le societa pg. 253

⁵⁶ Neni 89/1 i ligjit 9901/2008

❖ PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

❖ KUNDËRSHTIMI I VENDIMEVE TË ASAMBLESË SË ORTAKËVE

LTSHT nuk përmban ndonjë dispozitë lidhur me pavlefshmërinë ose kundërshtimin e një vendimi të asamblesë së ortakëve për shkakun se ky vendim ka shkelur ligjin ose statuti etj. Mungesa e një dispozite për të kundërshtuar vendimet e paligjshme të shumicës pasqyruar në një vendim asamble, mund të çojë në probleme kryesisht për mbrojtjen e ortakëve të pakicës por jo vetëm.

LTSHT nuk rregullon nulitetin ose anulueshmërinë e vendimeve të asamblesë për shkak se janë shkelur dispozitat ligjit ose procedura e thirrjes.

Nëse do i referohemi Kodit Civil atëherë janë të pavlefshme të gjitha vendimet për shkak të përmbajtjes se tyre të paligjshme (p.sh. nëse asambleja merr vendimin të zhvillojë një aktivitet kontrabandë që është i dënueshëm dhe penalisht ky vendim është nul).

Nëse asambleja thirret në mënyrë të parregullt, vendimmarrja e saj është e anulueshme pasi situata mund të rregullohet nëse gjithë ortakët janë dakord të marrin vendime.⁵⁷

Gjithashtu, në dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nuk janë trajtuar as rastet kur vendimet janë të pavlefshme në lidhje me votën e ortakut, p.sh. për shkak se vota është nul për ushtrim të dhunës fizike, për shkak të mungesës së prokurës ose tejkalim të tagrave të dhëna në autorizim, apo për shkak të konfliktit të interesit midis ortakut dhe atij që e përfaqëson në asamble etj.

Në lidhje me pavlefshmëritë ka një direktivë të BE, dhe pikërisht direktiva e parë e Këshillit, e datës 9 mars 1968, numër 151, e cila hodhi hapat e para në harmonizimin e legjislacioneve kombëtare në fushën e së drejtës tregtare. Kjo direktivë kishte si qëllim bashkërendimin e garancive që ju kërkohen shoqërive tregtare në shtetet anëtare, në mënyrë që të ketë mbrojtje ekuivalente në të gjithë komunitetin.

Në seksionin 3 të kësaj direktive trajtohet pavlefshmëria e shoqërive dhe kjo direktive është e zbatueshme për të gjitha llojet e shoqërive.

Sipas nenit 10 të direktivës, në të gjithë ato shtete anëtare, legjislacioni i të cilave nuk parashikon, gjatë kohës së formimit të një shoqërie, një kontroll

⁵⁷ Neni 83/2 i ligjit 9901/2008

parandalues, administrativ apo gjyqësor, akti i themelimit, **statuti si dhe çdo ndryshim** i tyre duhet të realizohen në formën e kërkuar ligjore (në formën e një akti publik).

Ndërsa në nenin 11 të saj është parashikuar se legjislacioni i shteteve anëtare nuk mund të sanksionojë pavlefshmërinë e shoqërive, përveçse në kushtet e mëposhtme:

- Pavlefshmëria duhet të shpallet me anë të një vendimi gjyqësor.
- Pavlefshmëria mund të shpallet veçse në rastet e mëposhtme:
 - a) Mungesa e aktit të themelimit, ose mosrespektimi i rregullave të kontrollit parandalues apo formaliteteve të caktuara ligjore.
 - b) Objekti i shoqërisë është i paligjshëm apo në kundërshtim me rendin publik.
 - c) Akti i themelimit apo statuti nuk kanë përcaktuar emrin e shoqërisë, të dhëna lidhur me nënshkrimet individuale të kapitalit, shumën totale e kapitalit të nënshkruar, objektin e shoqërisë.
 - d) Mosrespektimi i dispozitave kombëtare lidhur me shlyerjen e kapitalit minimal.
 - e) Paaftësia e të gjithë themeluesve të shoqërisë.
 - f) Në kundërshtim me ligjin kombëtar mbi shoqëritë tregtare, numri i themeluesve është më i vogël se dy.

Nëse nuk do të jemi përpara ndonjë rasti të mësipërm, shoqëria tregtare nuk mund të jetë subjekt i një çështjeje për in-ekzistencë, pavlefshmëri absolute, pavlefshmëri relative, anulueshmërie.

Në lidhje me sa më sipër, mendoj se mund të kemi një zbatim të këtyre dispozitave në rastin e ndryshimeve të statutit. Siç është përmendur dhe më sipër, këto ndryshime duhet të realizohen sipas ligjit, me vendim asambleje ose sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse. Nëse ky vendim që ndryshon statutin është në kundërshtim me ligjin mendoj se mund të goditet për pavlefshmëri, duke u interpretuar ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në kuadër të burimeve të tij sipas së drejtës evropiane. (Një rekomandim ky i dhënë dhe nga autorët e “Ligji i ri shqiptar për shoqëritë tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane” të cilët i orientojnë gjyqtarët dhe juristët të drejtohen burimeve prej të cilave është frymëzuar ligji ynë për të zgjidhur situatat ku nuk ka dispozitë që rregullon një situatë të caktuar).

Mendoj, gjithashtu, se një zgjidhje tjetër për këto mosmarrëveshje janë dhe dispozitat e Kodit tonë Civil që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë.

Për sa i përket praktikës gjyqësore ajo ka ecur në këtë drejtim, duke i dhënë zgjidhje shumë mosmarrëveshjeve midis ortakëve, duke përdorur si bazë ligjore nenin 92 të KC.

Përpara se të trajtoj këto çështje, kam konstatuar një situatë interesante në shumicën e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjyqtarët zbatojnë ligjin e vjetër për shoqëritë tregtare pavarësisht faktit se padia në gjykatën dhe gjykimi i çështjeve është zhvilluar pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Gjithashtu nuk sqarohet në këto vendime se përse zbatohet ligji i vjetër.

Veprimtaria gjyqësore konsiston në zbatimin e dispozitës ligjore (e hartuar përgjithësisht në terma të përgjithshëm dhe abstraktë) në një çështje specifike konkrete. Megjithatë, jo gjithmonë është e mundur për gjyqtarin të identifikojë normën (rregullin juridik) e zbatueshme në rastin në shqyrtim dhe një kërkim i tillë

kryhet prej tij duke përdorur një seri kriteresh interpretativë⁵⁸ (duke zbatuar këtu dhe aplikimin e ligjit në kohë).

Ligji i ri është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 06.05.2008 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, pra në datën 21.05.2008. Ligji ka dy dispozita transitorë që flasin për shoqëritë tregtare ekzistuese dhe zbatimin e këtij ligji për procedurat në vijim. Kështu sipas nenit 230 të ligjit rezulton se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shoqëritë tregtare ekzistuese do të vazhdojnë funksionimin, sipas mënyrës dhe kushteve që kanë qenë të vlefshme në çastin e regjistrimit të tyre. Pra, sipas një leximi të thjeshtë të kësaj pjese të dispozitës arrihet në konkluzion se statuti i tyre do zbatohet pavarësisht faktit se mund të vijë në kundërshtim me ligjin e ri. Vazhdimi i kësaj dispozite është se shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të tij janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, për situata që nuk janë të rregulluara në statut zbatohet automatikisht ligji i ri.

Sipas nenit 231 të ligjit, dispozitat e këtij ligji zbatohen për procedurat e themelimit ose të ndryshimit të një themeluesi, aksionari apo ortaku të shoqërisë, për procedurat e zgjedhjes së organeve, të miratimit të rregulloreve apo statutit dhe për procedura të tjera organizative, të nisura në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit.

Parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi.

Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme.⁵⁹

Në rastet që kam përmendur mendoj se gjyqtarët kanë qenë të detyruar të tregonin se përse zbatohet ligji i vjetër për aq kohë sa marrëdhënie midis palëve ose më saktë mosmarrëveshjet midis palëve kishin lindur pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

Vetëm themelimi i shoqërisë ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi dhe nuk ka rezultuar që gjykatat të zbatonin dispozitat e statutit të shoqërisë por thjesht dispozitat e ligjit të vjetër.

- ✓ Një rast që mendoj se paraqet interes është dhe çështja e zgjidhur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i datës 27.12.2011.

Në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes janë si më poshtë vijon:

Paditësit janë aksionare të shoqërisë “Riparim Makineri”sha. Kjo e fundit është regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, numër 14019, datë 19.02.1996.

Fillimisht aksionar i vetëm i kësaj shoqërie ka qenë Shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, e cila në bazë të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për Transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në Shoqëri Tregtare” si edhe ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarura dhe privatizimin” ka vendosur privatizimin e Shoqërisë nëpërmjet shitjes së saj me ankand.

⁵⁸ Shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

⁵⁹ shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese

Për shkak të njohjes të së drejtës së ish pronarit mbi truallin ku janë ndërtuar objekte të shoqërisë, paditësit kanë fituar pronësinë mbi aksione të saj, duke disponuar 43.06% të kapitalit themeltar të saj.

Aksionarët në mbledhjen e jashtëzakonshme kanë diskutuar, ndër të tjera në lidhje me “...Rillogaritja e aksioneve për trashëgimtarët e pronarit të tokës Xhemal Muharremi, duke pakësuar këto aksione në përqindje me vlerën e tokës që kanë hipotekuar në emrin e tyre. Të ndalohet shpërndarja e dividendëve për aksionet e trashëgimtareve dhe të ndalohet dividendët e marra në emrin e tyre....”.

Me vendimin nr.10, datë 26.12.2009, në pikat 3 dhe 4 të tij aksionarët e shoqërisë kanë vendosur: “...Të bëhet rillogaritja e aksioneve për trashëgimtarët e Xhemal Muharremit që janë aksionarë në shoqëri, për sipërfaqen e tokës prej 1920m² pronë e shoqërisë, që kanë hipotekuar padrejtësisht në emrin e tyre duke krijuar mbivendosje të dyfishtë, njëherë si aksionarë dhe nga ana tjetër si pronë me vete”.

Aksionarët i janë drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë të pikave 3 dhe 4 të vendimit nr. 10, datë 26.12.2009 të mbledhjes së shoqërisë “Riparim makineri” sha. Detyrimin e shoqërisë “Riparim makineri” sha tu japë dividendin në shumën 1.136.206,28 lekë.

Gjykata argumenton se:

Shoqëria “Riparim Makineri” sha përfaqëson një shoqëri aksionare në kuptim të nenit 105 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Nga aktet shkresore rezulton se një pjesë e kapitalit të saj (43.06 % pjesë) përfaqëson kontribut në natyrë “in kind” të paditësve, të cilët për shkak të marrëdhënies me truallin kanë përfituar aksione të shoqërisë.

Në bazë të nenit 128 të ligjit “dividendi shpërndahet mes aksionarëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë”.

Nga provat shkresore rezulton se paditësit janë të regjistruar si aksionarë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për 43.06 % pjesë të kapitalit themeltar. Për rrjedhim, ata legjitimohen të kërkojnë dividendin në përputhje me aksionet e disponuara.

Në këtë kontekst dividendi përfaqëson një të drejtë kredie të aksionarit ndaj shoqërisë, i kërkueshëm në momentin e miratimit të bilancit dhe të një vendimmarrje të asamblesë së përgjithshme (neni 135, shkronja “e” e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”).

Refuzimi për të shpërndarë fitimin e shoqërisë duke privuar në këtë mënyrë një pjesë të aksioneve do të mund të legjitimohet shoqërinë vetëm në rastet kur vullneti i aksionarëve synon të rrisë rezervën ligjore dhe të përmirësojë aftësinë financiare të shoqërisë, me qëllim përballimin e nevojave që diktohen nga një zhvillim produktiv, tregtar apo rinovimin e teknologjisë së përdorur të shoqërisë dhe që kërkon burime financiare, të ruaje integritetin e kapitalit në rastin e humbjeve të pësuar. Në këtë rast frutat civile që rrjedhin nga disponimi i aksioneve privohen për të gjithë kategorinë e aksionarëve.

Në kuptim të nenit 3 të ligjit, shoqëria përfaqëson bashkimin e vullneteve të disa subjekteve, qëllimi i të cilëve është arritja e objektivave ekonomike të përbashkët, realizimi i fitimit, e cila përbën edhe shkakun ligjor të kontratës së shoqërisë dhe aksionarëve të saj.

Nuk mund të pretendohet të refuzohet shpërndarja e dividendit për një pjesë të aksionarëve me justifikimin se trualli, kontribut në natyrë i tyre në kapitalin e shoqërisë, është cenuar nga veprimet në dëm të pasurisë së paluajtshme të shoqërisë. Kjo e fundit gëzon të drejtën që për pasurinë e saj të paluajtshme të përdorë të gjitha

mjetet ligjore që do të mbronin të drejtën e pronësisë. Për rrjedhim, vendimi nr. 10, datë 26.12.2009, pika 3 dhe 4 e tij, i asamblesë së përgjithshme është i kundërligjshëm dhe rrjedhimisht paditësat legjitimohen në kërkimin e tyre për shpërndarjen e dividendit në masën 1.136.206,28 lekë, që përfaqëson 43.06 % të aksioneve në shoqëri.

Gjykata konkludon në pranimin e padisë si të bazuar në ligj dhe në prova, duke anuluar pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 10, datë 26.12.2009 të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë “Riparim Makineri” sha dhe detyrimin e palës së paditur, shoqëria, të paguajë në favor të paditësave dividendin.

Në këtë rast gjykata ka zbatuar nenin 92 të Kodit Civil si dhe dispozitat e ligjit të ri për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.⁶⁰

Në situatën e mësipërme unë mendoj se dhe zbatimi i nenit 93 të ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare do ishte efektive pasi sipas kësaj dispozite ortaku që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Përfudimi do ishte i njëjtë, gjykata do kishte anuluar vendimin e asamblesë me argumenti se ishte shkelur nenin 93 i ligjit.

- ✓ Një rast tjetër interesant është trajtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1823, datë 28.02.2012.

Në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes janë si më poshtë vijon:

Paditësi BK dhe e paditura VH, me kontratën e datës 09.04.2008 kanë vendosur të krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar shoqëria “Sport Point” ShPK. me seli në Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie ka qenë zhvillimi i aktivitetit në fushën e tregtisë, përpunimit dhe prodhimit të konfeksioneve, tekstileve, aksesorëve e veglave sportive dhe mallrave të tjerë, si dhe import – eksportin e mallrave industriale, tekstile dhe konfeksione, ndërtimin dhe shfrytëzimin e terreneve sportive apo terreneve me lodra për të gjithë grup moshat.

Kapitali i shoqërisë ka qenë 100.000 lekë, e barabartë me 100 kuota me vlerë nominale 1000 lekë për çdo kuotë.

Kontributi i ortakëve në këtë shoqëri ka qenë 50 me 50, pra paditësi BK zotëron 50% të kapitalit themeltar, e paditura VH zotëron po 50 % të këtij kapitali.

Gjatë periudhës së ushtrimit të këtij aktiviteti, sipas nenit 19 të statutit të shoqërisë, e paditura VH është zgjedhur administratore e shoqërisë.

Për shkak të vështirësive ekonomike në treg, në mbështetje të parashikimeve në statut, nenin 27 e vijues të tij, me datë 19.05.2010 është thirrur asambleja e ortakëve për mbylljen e aktivitetit dhe fillimin e procedurës së likuidimit të shoqërisë.

Me vendimin nr. 1, datë 19.05.2010 të të dy ortakëve, është vendosur fillimi i procesit të likuidimit të shoqërisë, caktimi i DA si likuidator për likuidimin dhe mbylljen e shoqërisë dhe është autorizuar e paditura VH për kryerjen e veprimeve pranë QKR.

⁶⁰ Shih vendimin nr. 10771, datë 27.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është depozituar në QKR dhe shoqëria ka marrë statusin e shoqërisë në likuidim.

Dokumentacioni i shoqërisë i është dorëzuar likuidatores DA, e cila ka filluar procedurën e likuidimit.

Paditësi BK i është drejtuar gjykatës me padi dhe ka kërkuar pavlefshmërinë e vendimit datë 19.05.2010 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Sport Point" ShPK; zgjidhjen e pasojave të kësaj pavlefshmërie; detyrimin e të paditurës VH të dëmshpërblejë shoqërinë në vlerën e plotë të aseteve të shitura nën kosto; pezullimin e likuidimit të shoqërisë deri në fund të këtij gjykimi; vendosjen e sekuestros mbi asetet e shoqërisë; vendosjen e sekuestros mbi pasurinë personale të paditurës VH; vendosjen e sekuestros mbi dokumentet e arkës së shoqërisë.

Si bazë ligjore e padisë janë përdorur nenet 92/a, 81/dh, 16/b,98/1,2,3 të ligjit nr. 9901, datë 15.04.2008, si dhe nenet 202 e vijues të KPC.

Gjykata argumenton se:

Në nenin 92/1 të ligjit 9901/2008 parashikohet se "*asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit*".

Në rastin konkret, vendimi nr. 1, datë 19.05.2010 rezulton të jetë vendim i asamblesë së ortakëve dhe jo vendim i administratores.

Në këtë mbledhje kanë qenë të pranishëm të dy ortakët dhe vendimi është marrë nga të dy, unanimisht. Për rrjedhojë, ky vendim nuk mund të konstatohet i pavlefshëm pasi janë zbatuar normat e statutit dhe dispozitat e ligjit të sipërcituar. Për rrjedhojë, gjykata nuk konstaton shkaqe pavlefshmërie të këtij vendimi.

Vlen të përmendet se, në këtë rast praktik, gjykata ka argumentuar se në lidhje me këto vendime të asamblesë, si bazë ligjore do përdoren dispozitat e Kodit Civil. Meqenëse ligji special nuk rregullon këtë situatë me të drejtë gjykata i drejtohet Kodit Civil në të cilin rregullohen pavlefshmëritë si dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

Rastet e mësipërme janë paraqitur prej meje për të sqaruar se praktika gjyqësore ka ecur në lidhje me pavlefshmëritë ose kundërshtimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe asaj aksionare.

Duke qenë se ligji nuk përmbante ndonjë dispozitë lidhur me pavlefshmërinë e një vendimi të ortakëve, ose të drejtën për të kundërshtuar vendimin e tyre në gjykatë, me shkakun se ky vendim ka shkelur ligjin ose statutin, konsiderohej problematike nga ana e autorëve të tekstit "Ligji i ri shqiptar për të drejtën e shoqërive tregtare interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane", (që në fakt është një komentari i ligjit të ri për tregtarët dhe shoqëritë tregtare) zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve.

Autorët e tekstit mendonin se mungesa e dispozitave të tilla do të çonte në probleme kryesisht me mbrojtjen e ortakëve në pakicë. Gjithashtu nuk është dhënë ndonjë shpjegim se përse ligjvënësi nuk e ka parashikuar në ligj këtë situatë.

Autorët e tekstit ka dhënë argumentin se disa prej këtyre problemeve mund të zgjidhen duke zbatuar nenin 93 të LTSHT, ku parashikohet që ortaku i cili pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar.⁶¹

⁶¹Thomas Bacher, Edmund Philipp Schuster Martin Wnner Ligji i ri shqiptar për të drejtën e shoqërive tregtare. (interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane) pg 108-109

Megjithatë praktika ka ecur dhe ka zbatuar dispozitat e Kodit Civil. Nëse do i referohemi Kodit Tregtar të Zogut parashikohet se nëse ligji tregtar nuk rregullonte një situatë të caktuar në lidhje me marrëdhëniet tregtare, zbatoheshin zakonet tregtare, nëse nuk do kishte të tilla zbatohet Kodi Civil.

Sa më sipër gjyqtarët kanë aplikuar dispozitat e Kodit Civil në lidhje me pavlefshmërinë e vendimeve ose anulueshmërinë e tyre.

❖ PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE NË SHPK

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dallohen nga shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandime, pasi ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë. Vetëm shoqëria, me të gjithë pasurinë e saj, përgjigjet për detyrimet e saj.

Termi “përgjegjësi e kufizuar” duhet kuptuar në lidhje me ortakët por jo me subjektin që krijohet, pra me ShPK, pasi përgjegjësia e shoqërisë nuk është e kufizuar, shoqëria si person juridik me vete përgjigjet për detyrimet e saj me gjithë pasurinë që ka.

Nga ana tjetër ortakët nuk kanë përgjegjësi personale megjithatë ata marrin përsipër risk ekonomik duke kryer investimet në shoqëri. “Përgjegjësia e kufizuar” ka të bëjë me kufizimin e këtij rreziku.⁶²

Duke i qëndruar interpretimit të bërë nga autorët e “Ligjit shqiptar për të drejtën tregtare” bashkohem plotësisht me mendimin e tyre se ligji nuk e mbulon mirë dhe aspektin e përgjegjësisë së kufizuar tek ShPK.

Në nenin 68 të LTSHT parashikohet se ortakët “mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer” të kontributeve të nënshkruara. Sipas kësaj dispozite duket sikur shoqëria vetëm kur është në situatë të vështirë ekonomike, d.m.th kur ka humbje, mund ti kërkojë ortakëve të shlyejnë pjesën e pashlyer të kontributeve që kanë marrë përsipër të japin në shoqëri. Realisht nuk mund të jetë kështu, pasi shlyerja tërësore e kontributit është një detyrim kontraktor për ortakët, detyrim që e kanë marrë përsipër në momentin kur kanë rënë dakord të themelojnë shoqërinë, ndaj shoqëria mund ta kërkojë në çdo kohë shlyerjen e kontributit të ortakëve plotësisht, në rastet kur nuk janë shlyer nga ana e tyre, dhe jo vetëm kur ka nevoje për burim financiar.

Nga ana tjetër, fakti që ortakët kanë shlyer kontributet e tyre plotësisht, nuk do të thotë që ata nuk marrin përsipër asnjë risk ekonomik.

Kontributet janë investim që ka për qëllim të prodhojë kthimin e vet në formën e dividendëve ose të fitimeve etj. Në rast se shoqëria pëson humbje, nuk do të ketë as dividendë, aftësia e shoqërisë për t'i shlyer kontributet do të zvogëlohet. Ky është rreziku që merr përsipër çdo ortak të bëjë një investim në shoqëri dhe me alternativën që nuk ka siguri për kthimin e tij.⁶³

Në rast se të gjitha pasuritë e kontribuara nga ortakët janë përpirë nga humbjet e pësuar nga shoqëria, vetë shoqëria nuk do të ketë aftësi paguese dhe ortakët do të pësojnë humbje të gjithë investimit të tyre. Por ata nuk do të pësojnë më shumë se kaq, ndryshe nga ortakët e pakufizuar të shoqërisë kolektive ose shoqërisë

⁶² Thomas Bacher, Edmund Philipp Schuster Martin Winner Ligji I ri shqiptar për të drejtën e shoqërive tregtare. (interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën evropiane) fq 45

⁶³ Idem pg 46